



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 689 Akti

**Nr. 521 Vendimi
Tiranë, më 1.4.2022**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesues
Pamela Qirko	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, me datën 1.4.2022, ora 8:45, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore në lidhje me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Erjon Shehaj**, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH-së”;

Ligji 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Shehaj, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) më 15.12.2020 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj (Vokopola), Pamela Qirko dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues të datës 22.12.2020, kryesues u caktua me mirëkuptim komisionerja Alma Faskaj (Vokopola), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Në datën 3.8.2021, anëtarja Xhensila Pine paraqiti dorëheqjen nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, pas rënies në dijeni të konfliktit të interesit, kërkesë e cila u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues, i cili vendosi¹ pranimin e saj. Në vijim, anëtari zëvendësues i shortit të datës 22.12.2020, komisionere Brunilda Bekteshi, deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ, duke u bazuar edhe në kërkesën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë² për përfundimin brenda një kohe sa më të shpejtë të procesit ndaj subjektit të rivlerësimit, për shkak të kualifikimit si kandidat për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. Pas njoftimit të fillimit të procesit të rivlerësimit dhe njohjes me trupin gjykues, subjekti i rivlerësimit deklaroi³ mospasjen e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e tij.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje

1 Me vendimin nr. *** prot., datë 9.9.2021.

2 Kërkesë me nr. *** prot., datë 7.1.2021, e KLP-së drejtuar KPK-së, KPA-së dhe ONM-së.

3 Përmes njoftimit me *e-mail*.

me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në kuadër të kontrollit të pasurive/interesave privatë të subjektit të rivlerësimit është konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

10. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

11. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

12. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

13. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe me vendimin e datës 2.12.2021 vendosi: (i) përfundimin e hetimit për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe mbi të drejtat që gëzon sipas legjislacionit në fuqi.

14. Në vijim, po në datën 2.12.2021, subjektit i rivlerësimit u njoftua në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe metodologjinë e përgatitjes së saj. Subjekti i rivlerësimit u njoh me të gjitha aktet e dosjes më 3.12.2021, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

Në datën 22.12.2021, së bashku me shpjegimet dhe provat, subjekti paraqiti⁴ kërkesë për shtyrje të afatit për paraqitjen e disa akteve shkresore⁵ dhe kërkesë për riçelje hetimi për

⁴ Adresa elektronike ku është mbajtur komunikimi dhe protokollit zyrtar, nr. *** prot., datë 22.12.2021.

⁵ Për të provuar në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësve të babait të subjektit, si dhe mbi të drejtat e automjetit me targa ***.

të tria kriteret e rivlerësimit. Pas vlerësimit të kërkesave, trupi gjykues vendosi pranimin e pjesëshëm të tyre, duke caktuar një afat të ri për paraqitjen e shpjegimeve/provave deri në datën 5.1.2022, ndërsa vendosi të mos pranojë kërkesën për riçeljen e hetimit për kriteret e tjera, duke njoftuar subjektin se, nëse pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave, si dhe pas seancës dëgjimore do të provohej e kundërta e rezultateve të hetimit, trupi gjykues do të vendoste për ecurinë e procesit të rivlerësimit.

16. Në datën 5.1.2022, subjekti i rivlerësimit paraqiti në formë elektronike shpjegimet dhe prova të tjera shtesë, duke kërkuar administrimin e tyre bashkë me aktet e depozituara në shpjegimet e para të datës 22.12.2021.

17. Pas shqyrtimit në tërësi të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vendosi⁶ të ftojë z. Erjon Shehaj në seancë dëgjimore, në datën 7.1.2022, ora 10.00, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

18. Në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit pas relatimit të shpjegimeve në lidhje me rezultatet e hetimit, paraqiti kërkesë për riçelje hetimi për të tria kriteret e vlerësimit. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura nga subjekti pranë Komisionit dhe në seancën dëgjimore, provat e paraqitura në mbështetje të shpjegimeve, si dhe kërkesën e subjektit për riçelje hetimi, vendosi⁷ riçeljen e hetimit për dy kriteret e rivlerësimit: kontrollit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe njëkohësisht riçeljen e hetimit kryesisht për kriterin e vlerësimit të pasurisë, me qëllim kryerjen e disa verifikimeve⁸, në kuptim të hetimit të plotë dhe të gjithanshëm.

19. Në datën 9.3.2022, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar vendosi⁹: (i) përfundimin e hetimit për të tria kriteret e rivlerësimit; ii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për sa kishte rezultuar nga hetimi i Komisionit; (iii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe mbi të drejtat që gëzon sipas legjislacionin në fuqi. Subjekti u njoftua¹⁰ në lidhje me rezultatet e hetimit për të tria kriteret, si dhe ushtrimin e të drejtave ligjore të mbrojtjes brenda datës 21.3.2022. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më 11.3.2022, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

20. Subjekti i rivlerësimit, paraqiti¹¹ shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit brenda afatit të caktuar nga Komisioni. Në vijim, pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues vendosi¹² të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 29.3.2022, ora 10.00.

II. SEANCAT DËGJIMORE

21. Seancat dëgjimore për subjektin e rivlerësimit u zhvilluan në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datat 7.1.2022, ora 10:00 dhe 29.3.2022, ora 10.00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani të subjektit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

22. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit

⁶ Me vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 24.12.2021.

⁷ Me vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 7.1.2022.

⁸ Në lidhje me disa fakte të paraqitura nga subjekti në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit.

⁹ Me vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 9.3.2022.

¹⁰ Komunikim elektronik në datën 10.3.2022.

¹¹ Me postë elektronike të datës 21.3.2022, si dhe protokolluar me nr. *** prot., datë 23.3.2022.

¹² Me vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 25.3.2022.

administrativ. Në përfundim të procesit të kryer ndaj tij, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

23. Zoti Erjon Shehaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu përgjigjur në kohë pyetësorëve/kërkesave gjatë procedurës së hetimit administrativ, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

24. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

24.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

24.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

24.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

24.4. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit profesional.

24.5. Por, referuar vendimit nr. 2/2017¹³ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI së bashku me provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në mbështetje të deklaratës “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga

¹³41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.

ILDKPKI-ja së bashkë me provat në mbështetje të raportit; (c) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite nga subjekti; (ç) provat shkresore të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe ato të depozituara bashkë në seancën dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; si dhe f) denoncimet e publikut.

A. VLERËSIMI I PASURISË

25. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, në bazë të ligjit nr. 9049/2003 u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe të ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të tyre.

25.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, duke e krahasuar me deklaramet e interesave privatë dhe dokumentet shoqëruese, paraqitur më parë në ILDKPKI, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e vlerësimit të pasurive për subjektin e rivlerësimit.

25.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në verifikimin e krijimit të pasurive, ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij si person i lidhur me të. Në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar respektivisht këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme:

26. Subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe 84 m² +10 m² sipërfaqe e përbashkët në pallatin nr. ***, ap. nr. ***, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, marrë në përdorim me kontratë premtim shitje nr. ***, datë 14.1.2014, lidhur mes Erjon Shehaj dhe “****” sh.p.k. Vlera e këtij apartamenti është 62.000 euro (Sqarim vlera 62.000 euro = 45.600 euro likuiduar në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 7.5.2009 + 13.500 euro të likuiduara në kohën e lidhjes së kësaj kontrate + 2.900 euro të palikuiduara ende). 100% pjesë takuese.

26.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar : “.....(i) vlera në lekë e kredisë bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale prej 4.000.000 lekë me interes për 24 muajt e parë të pandryshuar (bono thesari jo më pak se 9%) dhe për periudhën e mbetur (bono thesari +3%, por jo më pak se 10%) për një kohëzgjatje 20 vjet sipas kontratës nr.*** datë 2.10.2009 pranë Bankës Popullore (Societe General) si dhe (ii) nga hua e marrë në vlerën 2.500.000 lekë sipas deklaratës noteriale nr.***datë 16.9.2009 nga shtetasi N. Sh., (babi im).

*Gjithashtu, është likuiduar edhe shuma 13.500 euro (diferencë e shtuar në vitin 2014) është paguar nga huaja e marrë në vlerën 14.000 euro nga shtetasi N.Sh., sipas deklaratës noteriale nr.*** datë 15.11.2013.....”*

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

27. Në deklaratën para fillimit të detyrës si prokuror¹⁴ të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin me sip. 78 m², të porositur në datën 7.5.2009 sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, me vlerë 48,000 euro si dhe ka deklaruar gjithashtu, në seksionin e detyrimeve financiare: 1) “Kredi bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale prej 4.000.000 lekë.....” 2) “Hua e marrë në shumën 2,500,000 lekë sipas deklaratës noteriale me nr. ***, datë 16.9.2009 dhe detyrimi i mbetur i pashlyer në shumën

¹⁴ Dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.9.2012.

2,100,000 lekë.” 3)“5% e pashlyer nga çmimi në total e pasurisë së paluajtshme në shumën 2400 euro”.

27.1. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar apartamentin e porositur në vitin 2009 dhe detyrimin ndaj babait të tij edhe në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim DIPP) të vitit 2009 të bashkëshortes së subjektit, znj. E. Sh., me përshkrimin si vijon: *1. Pasuri e paluajtshme, shtëpi banimi e porositur në dt 07.05.2009 e paregjistruar në regjistrin publik, sip 75 m², në adresë rruga “***” sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep dhe nr *** kol., datë 07.05.2009. Vlera 48,000 euro*. “2. Para të mbetura nga borxhi i marrë sipas përshkrimeve të bëra në këtë deklaratë nga z. N.Sh., për të likuiduar pjesën e pashlyer nga vlera totale e shpisë prej 2400 euro në vlerën prej 330,000 lekë”.

27.2. Gjithashtu, konstatohet se në DIPP/ 2009, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar huan e marrë nga babai i tij me përshkrimin “*Hua e marrë nga babai im N. Sh.,sipas deklaratës noteriale me nr. *** datë 16.9.2009*” në shumën 2,500,000, e pashlyer” si dhe “*Pjesa e mbetur e pashlyer nga vlera e apartamentit në shumën prej 2400 euro*”. Personi i lidhur me të, në seksionin e detyrimeve financiare të DIPP/2009, ka deklaruar “*kredi bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale prej 4.000.000 lekë me interes për 24 muajt e parë të pandryshuar (bono thesari jo më pak se 9%) dhe për periudhën e mbetur (bono thesari +3%, por jo më pak se 10%) për një kohëzgjatje 20 vjet sipas kontratës nr. **** datë 2.10.2009 pranë Bankës Popullore (Societe General), shlyer 2 këste me nga 74,000 lekë.*

27.3. Në vijim, në DIPP/2014, në seksionin e ndryshimit të pasurive/të drejtave reale, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*...Me kontratën nr. *** rep., nr. ***kol., datë 14.01.2014 është revokuar kontrata e sipërmarrjes me nr *** rep dhe *** kol., datë 07.05.2009 e lidhur mes Erjon Shehaj dhe “*****” shpk. Me këtë kontratë tashmë është bërë premtim shitblerje të një apartamenti 84 m2 + 10 m2 sip e përbashkët dhe anuluar gjithcka e përcaktuar në kontratën e mëparshme...”... Vlera 13,500 euro...”.*

27.3.1. Gjithashtu, në seksionin e detyrimeve financiare të DIPP/2014, subjekti ka deklaruar: *1) “Kredi bankare për blerje shtëpie në shumën 4,000,0000 lekë...”; 2) “... Hua e marrë në vlerën 2,500,000 lekë”; 3) “...Hua e marrë në vlerën 14,000 euro sipas deklaratës noteriale nr *** rep., nr *** kol., datë 14.01.2015...”. 4) “...Këst i pa shlyer nga çmimi në total i pasurisë së paluajtshme sipas kontratës nr *** rep., nr *** kol datë 14.01.2015¹⁵. Shuma 2,900 euro...”*

27.3.2. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu në seksionin e detyrimeve financiare të deklaratave vjetore të viteve 2010 - 2016 dhe në deklaratën “Vetting” gjendjen e detyrimit ndaj babait të tij z. N.Sh. nga huaja e dhënë subjektit në shumën 2,500,000 lekë, të cilat janë konsideruar nga Komisioni në kuptim të analizës financiare.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit për këtë pasuri

28. Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri ka rezultuar se Agjencia Shtetërore e Kadastrës¹⁶ (“ASHK”) nuk e konfirmon pasurinë e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit/personit të lidhur me të, por më tej u konstatua se subjekti nuk e ka lidhur ende kontratën e shitblerjes për shkak të mospagesës së plotë të çmimit ndaj palës shitëse.

28.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar përgjatë hetimit administrativ¹⁷, për këtë pasuri kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

¹⁵ Nga analizimi i deklaramit në raport me aktet provuese, duket se viti është shkruar gabim.

¹⁶ Referuar shkresave: me nr. *** prot., datë 5.2.2021, me nr. ***, datë 5.2.2021, dërguar nga drejtoritë respektive vendore Tiranë, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 11.1.2021, dërguar nga Komisioni.

¹⁷ Nga vlerësimi i dokumentacionit në dosjen e ILDKKPKI-së.

i. Në datën 7.5.2009 është lidhur fillimisht kontrata e sipërmarrjes¹⁸ mes shoqërisë “****”¹⁹ sh.p.k., në cilësinë e palës investitore dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës porositëse, me objekt porositjen e apartamentit nr. ***, me sipërfaqe 75 m², së bashku me ambientet e përbashkëta, në katin e *** teknik të pallatit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, i ndërtuar nga investitori sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 21.12.2004, në pronën e familjes V. dhe S., kundrejt çmimit 48,000 euro.

ii. Në datën 14.1.2014 është lidhur kontrata e premtim shitjes²⁰ mes shoqërisë “****” sh.p.k. (ish-shoqëria “****” sh.p.k.), përfaqësuar nga Y.Z. në cilësinë e palës premtuese shitëse, subjektit të rivlerësimit në cilësinë e palës blerëse, si dhe shtetasve Y. dhe F. Z. në cilësinë e dhënësve të pëlqimit²¹, këta të fundit si posedues të pasurisë objekt vlerësimi, në analizë të akteve të depozituara nga subjekti në ILDKPKI.

iii. Referuar kontratës për premtim shitjeje të datës 14.1.2014, shoqëria e ndërtimit “****” i premtton subjektit të rivlerësimit se do t’i kalojë pronësinë mbi apartamentin nr. *** me sipërfaqe 84 m² dhe sipërfaqe 10 m² ambiente të përbashkëta, në katin e *** teknik të të njëjtit pallat, me regjistrimin e tij në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

iv. Gjithashtu, sipas kësaj kontrate, palët pranojnë njëkohësisht revokimin e kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.5.2009, me të cilën është porositur apartamenti me sip. 75 m² në vitin 2009 dhe të kontratës për premtim shitjeje me nr. *** rep., dhe *** kol., të lidhur mes shtetasve Z., Sh. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në lidhje me këtë pasuri.

Në lidhje me shlyerjen e çmimit të shitblerjes së pasurisë

29. Referuar kontratës për premtim shitjeje të datës 14.1.2014, çmimi është përcaktuar në vlerën 62,000 euro, shlyerja e të cilit është përcaktuar si vijon: (i) kësti i parë prej 45,600 eurosh është likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.5.2009; (ii) kësti i dytë prej 13,500 eurosh është likuiduar në prezencë të noteres ditën e nënshkrimit të kontratës, më 14.1.2014, shumë të cilën pala shitëse e ka marrë dhe nuk ka asnjë pretendim për këtë vlerë të likuiduar; (iii) ndërsa kësti i fundit në vlerën prej 2,900 eurosh do të likuidohet me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës, sipas ligjit.

29.1. Nga administrimi i dokumentacionit konstatohet se nga çmimi prej 62,000 eurosh, është paguar shuma në total prej 59,100 eurosh, duke mbetur një detyrim i papaguar ndaj shoqërisë në vlerën 2,900 euro. Shuma prej 59,100 eurosh është shlyer në këstet si vijon: *i)* Në procesverbalin e datës 10.11.2014²², kur janë pyetur nga ILDKPKI në lidhje me kohën e likuidimit të çmimit, subjekti dhe bashkëshortja e tij, znj. E. Sh., kanë konfirmuar se pagesa është kryer sipas kushteve të kontratës dhe konkretisht në datën 11.5.2009 është paguar shuma prej 30,000 eurosh, ndërsa në datën 7.10.2009 është paguar shuma 15,600

¹⁸ Kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.5.2009. aneksi *** e ILDKPKI-së.

¹⁹ Identifikuar me NUIS ****.

²⁰ Kontratë premtim shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.1.2014, aneksi *** i ILDKPKI -së.

²¹ Referuar dokumentacionit bashkëlidhur kontratës për premtim shitjeje të vitit 2014, në lidhje me pasurinë apartament me sip. 84 m² rezulton se kjo pasuri është porositur më parë nga shtetasja F.Z. me kontratën e sipërmarrjes të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. me nr. *** rep., dhe ***kol., datë 21.8.2009. Në datën 27.1.2011 shtetasja F. Z. (pala e parë) ka lidhur kontratë premtim shitjeje me nr. *** rep dhe *** kol., me shtetasin N.Sh.(pala e dytë) me dijeninë e shoqërisë “****” sh.p.k. me objekt premtim shitjeje të disa pasurive, ndër të tjera edhe apartamentin me sip 84 m². Në vijim, me aktin revokim kontrate, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2011, palët revokojnë kontratën për premtim shitjeje të vitit 2011 dhe pala e parë, pra shtetasja Z., rifiton përsëri të drejtat e kaluara mbi apartamentin me sip 84 m².

²² I administruar me shkresën kthim përgjigjeje me nr. **** prot., datë 23.11.2021, të ILDKPKI-së.

euro. Nga hetimi i mëtejshëm i Komisionit ka rezultuar se brenda datës 15.5.2009, kjo vlerë është depozituar në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit, sipas mandatdepozitimeve bankare përkatëse²³ e konkretisht: në datën 12.5.2009, shtetasi Y.Z. ka depozituar në llogarinë e shoqërisë “****” shumën 20,000 euro²⁴, me përshkrimin “*Dep për blerje apartamenti nr ***, kati ***, teknik Erion Shehaj*”, ndërsa në datën 15.5.2009, shtetasi Y.Z. ka depozituar në llogarinë e shoqërisë “*****” sh.p.k shumën 10,000 euro²⁵, me përshkrimin “*Dep për blerje apartamenti nr ***, kati ***, teknik Erion Shehaj*”.

ii) Në datën 7.10.2009 është paguar vlera prej 15,600 eurosh, bazuar në deklaratën noteriale²⁶, të nënshkruar nga subjekti dhe pala shitëse.

iii) Në datën 14.1.2014 është paguar vlera prej 13,500 eurosh, bazuar në kontratën për premtim shitjeje të lidhur midis palëve.

29.2. Komisioni, në vijim, nisur nga vlera e çmimit për blerjen e këtij apartamenti, e cila përfshinte dhe mobilimin e pajisjet e nevojshme të lëna nga shitësi, sipas subjektit²⁷, vlerësoi të hetonte edhe në kuadër të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me palën shitëse. Nga hetimi i Komisionit nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit²⁸ /bashkëshortja²⁹ e tij të kishin hetuar/shqyrtuar çështje në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k, apo shtetasve Z. si administrator apo individë.

Analiza e burimeve të krijimit

A) Në lidhje me burimet që kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë në vlerën 30,000 euro

30. Komisioni ka analizuar burimet e krijimit, referuar deklaratimit të subjektit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, ka krahasuar atë me deklaratën vjetore të subjektit dhe personit të lidhur me të, si dhe ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në kuptim të vërtetësisë së deklarimeve si dhe provueshmërisë së burimeve të krijimit.

30.1. Në lidhje me kredinë bankare në shumën 4,000,000 lekë, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit dhe administruar në kuadër të rivlerësimit, Komisionit i rezultoi se kredia është marrë në datën 6.10.2009 pranë “OTP Bank”³⁰ nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, kredi e cila rezulton e mbyllur në datën 6.12.2017.

30.2. Në vijim ka rezultuar se subjekti ka tërhequr këtë kredi në pjesë: në datën 6.10.2009 ka tërhequr shumën *cash* 2,200,000 lekë; në datën 8.10.2009 ka tërhequr shumën *cash* 400,000 lekë; në datën 13.11.2009 ka tërhequr shumën *cash* 100,000 lekë dhe; në datën 31.12.2009 ka tërhequr shumën 1,247,000 lekë.

²³ Mandatdepozitimet e “NGB BANK”, pjesë e dosjes së hetimit “OTP Bank”.

²⁴ Mandatdepozitimi *cash* në “NGB BANK” në shumën 20,000 euro, në shkresën nr. **** prot., datë 20.1.2021, nga “OTP BANK”.

²⁵ Mandatdepozitimi *cash* në “NGB BANK” në shumën 10,000 euro në shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2021, nga “OTP BANK”.

²⁶ Deklarata noteriale për shlyerje detyrimi të pjesshëm me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2009, aneksi 4/2 i ILDKPKI-së .

²⁷ Shih përgjigjen 14 të pyetësorit të parë.

²⁸ Me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

²⁹ Shkresë kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 1.11.2021, dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë; shkresë kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 27.10.2021, dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë; shkresë kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 2.11.2021, dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁰ Kontrata e kredisë nr. ***rep., nr. *** kol., datë 2.10.2009, në shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2021, nga “OTP BANK”, faqe ***.

30.3. Duke qenë se kredia është disbursuar para pagesës së këstit të parë prej 30,000 eurosh, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime gjatë hetimit administrativ, si dhe ka administruar dhe vlerësuar dokumentacion provues të paraqitur nga subjekti në lidhje me burimet e krijimit.

30.4. Për të vlerësuar në lidhje me burimet financiare për krijimin e shumës prej 2,500,000 lekë dhënë hua nga babai i subjektit, z. N.Sh., në vitin 2009, Komisioni ka analizuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, si dhe përgjatë hetimit administrativ³¹, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit 84/2016, si dhe dokumentacionin e siguruar nga hetimi administrativ.

30.4.1. Në mbështetje të deklaratës “Vetting”, subjekti ka paraqitur akte provuese: i) lëvizje llogarie³² të pagës së babait N. Sh., periudha 9.9.2005 - 26.12.2007 dhe 4.11.2008 - 31.12.2015; ii) libeze³³ pune të N. Sh.; iii) lëvizje llogarie³⁴ në BKT të N. dhe K.Sh. ndër vite; iv) lëvizje llogarie³⁵ të pagës të nënës së subjektit, znj. K.Sh., për periudhën 16.12.2004-18.06.2007; v) vërtetim page³⁶ për K. Sh.nga “Ujësjellës - Kanalizime”, Sarandë, lëshuar në datën 21.10.2016; vi) kontratë për hapje depozite bankare pranë “Procredit Bank”, datë 4.6.2009, në shumën 270,000 lekë; vii) kontratë për hapje depozite bankare pranë “Procredit Bank”, datë 30.4.2012, në shumën 270,000 lekë; viii) kontratë shitjeje³⁷ pasuri e paluajtshme të vitit 2001, të lidhur midis N. dhe K. Sh. në cilësinë e shitësve dhe shtetasit P.Z.në cilësinë e blerësit, për shitjen e një sipërfaqe trualli prej 560 m², në qytetin e Sarandës, në vlerën 400,000 lekë; ix) kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.1992, e lidhur midis Seksionit Financiar të Rrethit Sarandë në cilësinë e shitësit dhe z. N. Sh. në cilësinë e blerësit, për blerjen e truallit prej 560 m², çmimi i së cilës është i palexueshëm; x) kontratë për privatizimin e banesave e lidhur në datën 1.6.1993³⁸ midis Ndërmarrjes Komonale Banesa Sarandë dhe z. N.Sh. për privatizimin e banesës nr. ***, ap. ***, shk. ***, kati ***, e përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë në shumën 2130 lekë; xi) shkresë me nr. *** prot., datë 21.10.2016 nga Drejtoria e ALUIZNIT, Sarandë me lëndë “pajisje me vërtetim për objekt informal”.

30.4.2. Në vijim, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur dokumentacion vijues për të provuar mundësitë financiare të babait të tij, z. N. Sh., i) vërtetim nga ISSH-ja për pagat e babait N. Sh. për periudhën 1998-2010; ii) vërtetim nga ISSH-ja për pagat e nënës K. Sh. për periudhën korrik 2004 - mars 2006 e në vijim nga janar 2012 - gusht 2020; iii) kontratë shitjeje³⁹ pasuri e paluajtshme të vitit 2001, të lidhur midis N. dhe K.Sh.në cilësinë e shitësve dhe shtetasit P. Z.në cilësinë e blerësit, për shitjen e një sipërfaqe trualli prej 560 m², në qytetin e Sarandës, me dokumentacion: iv) deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.9.2009, lëshuar nga shtetasit S. N. dhe N.Sh., sipas të cilës kanë deklaruar se për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, z. S.N. i jep djalit të dajës z. N. Sh. një shumë hua prej 1,500,000 lekësh pa interes dhe për një periudhë të pacaktuar për kthimin e saj, të cilën z. Sh. *do ta përdorë bashkë me kursimet e tij të mbledhura ndër vite, për t'ia dhënë subjektit të rivlerësimit me qëllim likuidimin e një apartamenti të porositur prej tij në Tiranë;* v) vërtetim nga DRT-ja Gjirokastër me nr. *** prot., datë 20.1.2021, në lidhje me qarkullimin vjetor të realizuar nga personi fizik “S.N.” me Nipt ***, me objekt aktiviteti “*tregti më pakicë artikujsh ushqimorë etj*”, për vitet 2004, 2005,

³¹ Përgjigjia e pyetjes 2 të pyetësorit të dytë, datë 5.11.2021.

³² Pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, faqe *** dhe ***.

³³ Pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, faqe ***.

³⁴ Pjesë e dosjes dosjes së ILDKPKI-së, faqe ***.

³⁵ Pjesë e dosjes dosjes së ILDKPKI-së, faqe ***.

³⁶ Pjesë e dosjes dosjes së ILDKPKI-së, faqe ***.

³⁷ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.8.2001, ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së faqe ***.

³⁸ Vërtetuar me vërtetimin noterial me nr. *** rep., dhe ***kol., datë 11.6.1993.

³⁹ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.8.2001, ndodhur në dosjen e ILDKPKI, faqe ***.

2006, bashkë me dokumentacionin mbështetës; vi) vërtetim nr. *** prot., datë 29.12.2020, lëshuar nga Bashkia Gjirokastrë në lidhje me pagesën e detyrimeve të taksave vendore për periudhën nga viti 2002 - 2009 nga personi fizik "S. N."; vii) shkresë me nr. *** prot., datë 31.12.2020, kthim përgjigjeje, lëshuar nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Gjirokastrë, drejtuar z. S. N., bashkë me dokumentacionin mbështetës.

30.5. Nga vlerësimi i dokumentacionit konstatohet se të ardhurat e prindërve të subjektit, për periudhën 1 janar 1998 - 16 shtator 2009, rezultojnë të jenë në vlerën totale rreth 4,317,000 lekësh dhe pas zbritjes së shpenzimeve jetike, për periudhën 1 janar 1998 - 16 shtator 2009, në vlerën rreth 2,602,000⁴⁰ lekë, mundësia e prindërve për të kursyer do të ishte maksimalisht rreth 1,714,000 lekë. Gjithashtu, nga vlerësimi në tërësi i dokumentacionit në lidhje me mundësitë financiare të z. S. N. për t'i dhënë hua babait të subjektit shumën 1,500,000 lekë, duket se ai ka realizuar të ardhura të konsiderueshme nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si person fizik me objekt "*tregti e artikujve të ndryshëm*" dhe nga shitja e dy pasurive të paluajtshme ndër vite si individ. Në analizën e kryer fillimisht nga Komisioni, këto burime u konsideruan me rezervë, për shkak të mosdeklarimit të tyre në deklaratën "Vetting", si burime të pagesës së këstit të parë të apartamentit.

30.6. Nga analiza e kryer, mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga hetimi, Komisioni përgatiti analizën financiare paraprake, për sa nuk u provua shlyerja e këstit të parë prej 30,000 eurosh me burim nga kredia pranë Bankës Popullore dhe nga huaja e marrë nga babai i subjektit.

30.7. Bazuar në faktet dhe analizën financiare të kryer, subjektit i kaloi barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar dhe shpjeguar në lidhje me pasaktësitë e deklarimeve për burimet e krijimit që kanë shërbyer për shlyerjen e këstit të parë, për të justifikuar burimet e ligjshme të të ardhurave të babait për t'i dhënë hua subjektit shumën 2,500,000 lekë, për pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të paguar këstin e parë në shumën 30,000 euro në datën 15.5.2009.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

31. Subjekti në shpjegimet e tij ka kundërshtuar faktin e pamundësisë financiare për pagesën e këstit të parë të çmimit në shumën prej 30,000 eurosh, duke paraqitur argumentet e tij si dhe prova të reja, të cilat, sipas subjektit, duhet të konsiderohen në analizën financiare e për rrjedhojë do të rezultonte një situatë pozitive financiare në favor të subjektit të rivlerësimit.

31.1. Subjekti, në shpjegimet e tij, ka deklaruar se nuk ka pasur pasaktësi në deklaram, pasi ai ka deklaruar burimet reale që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, burime të cilat ai i ka pasur gjendje në fund të vitit 2009, prandaj dhe i ka deklaruar në mënyrë konsistente në deklaratën e vitit 2009, të dorëzuar nga bashkëshortja e tij, si dhe në deklaratën "Vetting". Ai ka theksuar se burimet e krijimit kanë qenë huaja e marrë nga babai i tij në shumën 2,500,000 lekë dhe kredia bankare për blerje pasurie në shumën prej 4,000,000 lekësh, burime të deklaruara në DIPP dhe deklaratën "Vetting".

31.2. Subjekti ka sqaruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit ku ai dhe bashkëshortja e tij janë gjendur kur kanë porositur apartamentin. Ai ka sqaruar se në vitin 2009 ka shfaqur interes për blerjen e një apartamenti në Tiranë dhe pasi kanë marrë kontaktet me shoqërinë e ndërtimit, kanë rënë dakord për porositjen e apartamentit, duke bërë në të

⁴⁰ Shpenzimet jetike janë përlogaritur sipas ILDKPKI-së për 2 persona; përkatësisht për periudhën 2000 - 2009 sipas ILDKPKI-së, ndërsa për vitet 1998-1999, sipas shpenzimeve të vitit 2000, sipas informacionit të ILDKPKI-së me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019.

njëjtën kohë edhe planin për përbalimin e blerjes. Për të formalizuar marrëdhënien e shitblerjes, shoqëria e ndërtimit ka kërkuar medoemos pagesën e të paktën një kësti në shumën prej 30,000 eurosh. Të gjendur në kushte të ngutshme të vendosura nga shoqëria, ndërkohë që ende nuk ishte aplikuar dhe as përftuar kredia bankare, ata kanë diskutuar familjarisht për të gjetur mundësinë e fondeve për kryerjen e pagesës së këstit të parë ndaj palës shitëse përkohësisht, deri në datën 15 maj 2009. Në këto kushte, subjekti sqaron se i është ofruar i afërmi i tij z. S. Ç.(djali i xhaxhait të nënës së tij) për ta ndihmuar nëpërmjet një huaje të përkohshme (disa mujore) në shumën 30,000 euro, dhënë prej tij në cilësinë e administratorit dhe ortakut mazhoritar të shoqërisë “****” sh.p.k.

31.2.1. Mbi rrethanën e mësipërme, subjekti ka deklaruar se nga palët është përpiluar deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol, datë 30.4.2009, me përmbajtjen e së cilës dëshmohet fakti dhe shuma e dhënë hua nga i afërmi kundrejt babait të tij, me qëllim pagesën e përkohshme të vlerës së kontratës dhe si burim i huas kanë shërbyer të ardhura nga qarkullimi i realizuar i subjektit huadhënës, deri në prill të vitit 2009.

31.3. Subjekti ka arsyetuar se bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, ai ka deklaruar pasurinë si dhe detyrimet që kanë rezultuar në mbyllje të vitit 2009, pra kredia në shumën 4,000,000 lekë dhe huaja në shumën 2,500,000 lekë nga babai i tij dhe se nuk ka pasur detyrim të deklaronte huan e marrë nga shoqëria “****”, pasi ajo ka qenë një marrëdhënie e përkohshme detyrimi, e krijuar për përdorim disamujor dhe e mbyllur brenda vitit 2009.

31.4. Subjekti ka vijuar shpjegimin se pas pagesës së këstit të parë prej 30,000 eurosh nëpërmjet huas së dhënë babait të tij nga shoqëria “****”, ka menduar për pagesën e këstit të dytë në shumën prej 18,000 eurosh (apo ekuivalenti në shumën 2,500,000 lekë), të cilën e siguroi nga babai dhe e dokumentoi me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.9.2009, por që edhe për shkak të marrëdhënieve të posaçme, nuk e kishte marrë në dorëzim, pasi do ta posedonte atë në momentin që praktikisht do të kryente edhe pagesën kundrejt ndërtuesit.

31.4.1. Ndërkohë, në tetor të vitit 2009, është disbursuar shuma e kredisë prej 4,000,000 lekësh dhe i gjendur në kushtet për ta mbyllur detyrimin e këstit të dytë dhe gjithashtu për lehtësi veprimi në Tiranë, pasi shumën prej 2,500,000 lekë, të dhënë hua nga babai ka shpjeguar se ua kishte lënë prindërve në dorëzim në Sarandë, ka proceduar me tërheqjen e shumës prej 2,200,000 lekësh nga kredia e disbursuar dhe ka paguar këstin e dytë në datën 7.10.2009, ekuivalentuar në euro në shumën 15,600 euro. Këtë pagesë e ka formalizuar me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 7.10.2009.

31.5. Subjekti ka shpjeguar gjithashtu në lidhje me shlyerjen e huas ndaj shoqërisë “****”, se kjo hua është shlyer nga huaja e marrë nga babai i tij në shumën prej 2,500,000 lekësh, si dhe nga shuma e kredisë së mbetur, të cilën e ka tërhequr deri në fund të vitit 2009 dhe ia ka dhënë babait të tij. Në shpjegimet shtesë të datës 5.1.2022, subjekti ka sqaruar se huaja ndaj kësaj shoqërie është mbyllur brenda vitit 2009 dhe për këtë ka paraqitur në cilësinë e provës një deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.1.2022, sipas së cilës shoqëria “****” deklaroi se huaja e marrë nga z. N. Sh. është kthyer brenda vitit 2009 dhe se nuk ka më detyrime ndaj kësaj shoqërie.

31.6. Për të provuar në lidhje me mundësitë financiare të shoqërisë “****” për të dhënë huan e përkohshme prej 30,000 eurosh, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave aktet: (i) deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2009 të lidhur midis “****” sh.p.k., në cilësinë e huadhënësit dhe N. Sh. në cilësinë e huamarrësit, në lidhje me marrjen e huas nga ky i fundit të shumës 30,000 euro me përshkrimin *për t'ia dhënë djalit të tij për prenotimin e një apartamenti në Tiranë*; (ii) vendim i gjykatës i datës 13.10.1997 për regjistrimin e shoqërisë “****” sh.p.k.; (iii) akthemelimi i datës 13.10.1997 për këtë shoqëri; (iv) statutin e datës 13.10.1997 për shoqërinë; (v) ekstrakt historik nga QKB-ja

për “***” sh.p.k (ndryshuar emri i mëparshëm nga “***” sh.p.k.), të lëshuar në datën 20.12.2021, me administrator S. Ç. dhe ortak me 66% të pjesëmarrjes në shoqëri prej vitit 1999 e në vijim; (vi) disa vendime asambleje, kryesisht për miratimin e tabelave financiare për shoqërinë ndër vite; (vii) lëvizje llogarie bankare të shoqërisë për periudhën 2005-2009.

31.7. Mbi konstatimin e Komisionit, subjekti ka vijuar të shpjegojë ndër të tjera se nuk ka pasur mospërputhje të deklarimeve për burimet e ligjshme të babait të tij për sigurimin e shumës së dhënë hua prej 2,500,000 lekësh. Ai ka sqaruar se në ILDKPKI ka deklaruar aq sa është pyetur, duke qenë se natyra e verifikimit të kryer nga ILDKPKI ka qenë thjesht konfirmuese për marrëdhënien e huas dhe në vijim kur është pyetur nga Komisioni, është përpjekur të sigurojë burimet e krijimit të shumës së dhënë hua nga babai i tij. Ai ka theksuar se prindërit e tij nuk kanë pasur mundësi për të blerë/dhuruar pasuri, por me kursime nga burime të ligjshme dhe nga hua të marrë tek të afërm kanë mundur të sigurojnë huan për porositjen e apartamentit të tij.

31.8. I pyetur në lidhje me burimet që kanë shërbyer për shumën e dhënë hua nga babai i tij në masën 2.500.000 lekë, subjekti ka sqaruar se për sigurimin e kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat e ligjshme të përfituara nga punësimi i prindërve të tij, të ardhurat nga shitja e një pasurie të paluajtshme në vitin 2001, si dhe huaja e marrë nga kushëri i babait të tij, z. S. N., në shumën 1,500,000 lekë, sipas deklaratës noteriale të kohës, të datës 12.9.2009. Subjekti i ka kërkuar Komisionit të konsiderojë burimet e krijimit të shumës së dhënë hua prej 2,500,000 lekësh, pasi ato përfaqësojnë burime të ligjshme.

31.9. Për të provuar në lidhje me mundësitë financiare të prindërve të tij si dhe të z. S. N. si burime krijimi të huas së dhënë subjektit në shumën 2,500,000 lekë, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave aktet: i) vërtetim nga ISSH-ja për pagat e babait N. Sh., për periudhën 1998-2010; ii) vërtetim nga ISSH-ja për pagat e nënës K. Sh., për periudhën korrik 2004 - mars 2006 e në vijim nga janar 2012 - gusht 2020; iii) kontratë shitjeje⁴¹ pasuri e paluajtshme të vitit 2001, të lidhur midis N. dhe K. Sh. në cilësinë e shitësve dhe shtetasit P.Z., në cilësinë e blerësit, për shitjen e një sipërfaqe truall prej 560 m² në qytetin e Sarandës së bashku me dokumentacion; (iv) shkresë me nr. *** prot., datë 3.12.2021, lëshuar nga ASHK-ja Sarandë, me objekt “kthim përgjigjeje” në lidhje me pasurinë truall të shitur në vitin 2001 shtetasit P.Z. dhe informacion në lidhje me taksën e paguar për efekt kalimi të kësaj pasurie, bashkë me dokumentacionin mbi asgjësimin e aplikimeve dhe mandatpagesave të ZVRPP-së për periudhën 2000-2007; (v) deklaratë noteriale me nr. ***rep., nr. ***kol., datë 12.9.2009, lëshuar nga shtetasit S. N. dhe N.Sh., sipas të cilës kanë deklaruar se *për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, z. S. N. i jep djalit të dajës z. N. Sh. një shumë hua prej 1,500,000 lekë pa interes dhe për një periudhë të pacaktuar për kthimin e saj, të cilën z. Sh. do ta përdorë bashkë me kursimet e tij të mbledhura ndër vite, për t’ia dhënë subjektit të rivlerësimit me qëllim likuidimin e një apartamenti të porositur prej tij në Tiranë*; (vi) vërtetim nga DRT-ja Gjirokastër me nr. *** prot., datë 20.1.2021, në lidhje me qarkullimin vjetor të realizuar nga personi fizik “S. N.” për vitet 2004, 2005, 2006, bashkë me dokumentacionin mbështetës; (vii) vërtetim nr. *** prot., datë 29.12.2020 lëshuar nga Bashkia Gjirokastër në lidhje me pagesën e detyrimeve të taksave vendore për periudhën nga viti 2002-2009 nga personi fizik “S.N.”; (viii) shkresë me nr. *** prot., datë 31.12.2020, kthim përgjigjeje, lëshuar nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Gjirokastër, drejtuar z. S.N., bashkë me dokumentacionin mbështetës; (ix) informacion i përgjithshëm i printuar nga sistemi *Cats* i tatimeve për “S. N.” person fizik, me statusin “i çregjistruar”, datë 27.5.2010, të paraqitur në formë të njëzuar me origjinalin.

⁴¹ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.8.2001, ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, faqe ***.

Mbi verifikimet e kryera nga Komisioni në lidhje me huan në shumën 30,000 euro nga shoqëria “**” sh.p.k., në kuadër të riçeljes së hetimit kryesisht**

32. Pas kalimit të barrës së provës subjektit në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare të pagesës së këstit të parë prej 30,000 eurosh dhe pas paraqitjes së shpjegimeve dhe provave nga subjekti në lidhje me mbulimin e këtij kësti me huan e marrë shoqërisë “****” sh.p.k., trupi gjykues vendosi të riçelë hetimin për të kryer verifikimet e nevojshme, si dhe për të hetuar më tej në lidhje me vërtetësinë e kësaj huaje të deklaruar nga subjekti, si burim i përkohshëm për shlyerjen e këstit të parë.

32.1. Në kuadër të verifikimeve të kryera, Komisioni i ka kërkuar informacion noterit publik⁴² në lidhje me regjistrimin e deklaratës noteriale të datës 30.4.2009, të lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me qëllim verifikimin e regjistrimit të deklaratës noteriale në regjistrin e akteve noteriale.

32.2. Në vijim, Komisioni ka administruar statutin⁴³ e shoqërisë “****” sh.p.k. të datës 13.10.1997, në fuqi në kohën e dhënies së huas, për të verifikuar kompetencat e administratorit në lidhje me veprimtaritë e tij me të tretët. Nga analizimi i tagrave të tij nuk duken kufizime të kompetencave të administratorit për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë.

32.3. Referuar ligjit nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, parashikohet⁴⁴ se në rastet kur shoqëria hyn në marrëdhënie me një palë të tretë, i cili është i afërm me personin e autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë, veprimi duhet të jetë i autorizuar nga ortakët e shoqërisë. Nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk u konstatua vendimmarrje/ autorizim nga asambleja e ortakëve në lidhje me këtë huadhënie.

32.3.1. Gjithashtu, Komisioni konstaton se referuar ekstraktit të llogarisë së shoqërisë, paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, për periudhën 8.1.2009 - 24.4.2009, janë kryer veprime tërheqje *cash* nga llogaria e shoqërisë në shumën totale 12,500,000 lekë, likuiditete të cilat në raport me huan e dhënë babait të subjektit, përfaqësojnë trefishin e vlerës së dhënë hua.

32.4. Pas kryerjes së verifikimeve nga Komisioni për huan e dhënë nga shoqëria e mësipërme, subjektit iu kërkuar shpjegime në lidhje me sa rezultoi nga verifikimi, si dhe të paraqiste dokumentacion të plotë provues të shoqërisë “****” në lidhje me huan e dhënë babait të tij z. N. Sh. në shumën 30,000 euro.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të reja të hetimit

33. Subjekti në shpjegimet e tij ka sqaruar se shuma e dhënë hua nga shoqëria “****” sh.p.k., përbënte një të ardhur të siguar nga qarkullimi i kësaj shoqërie për periudhën vjetore deri në dhënien e kësaj huaje (deri në datën 30.4.2009). Ai ka theksuar se me dokumentacionin e paraqitur më parë në rezultatet e para të hetimit, si dhe informacionin e marrë rishtazi nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sarandë në lidhje me xhiron vjetore për periudhën janar – prill 2009, të realizuar nga shoqëria “****” sh.p.k., arrihet të provohet mundësia financiare e kësaj shoqërie për të dhënë huan në datën 30.4.2009. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën me nr. *** prot, datë 15.3.2022, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sarandë.

33.1. Për sa i përket dijenisë së ortakëve në lidhje me huan e dhënë nga shoqëria, subjekti ka sqaruar se ekzistenca ose jo e një autorizimi ndërmjet ortakëve, përbën një praktikë pune që lidhet me menaxhimin e brendshëm të shoqërisë dhe raportin e marrëdhënieve

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 11.1.2022, drejtuar noterit Publik M.M.

⁴³ Verifikuar në faqen zyrtare të QKB-së <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

⁴⁴ Neni 13. pika 3 e ligjit nr. 9901/2008.

tregtare ndërmjet ortakëve të një shoqërie, e cila rregullohet sipas legjislacionit përkatës. Subjekti gjithashtu ka sqaruar se referuar informacionit shkresor të marrë së fundmi nga shoqëria “****” sh.p.k., të cilën e ka paraqitur në cilësinë e provës, edhe ortaku tjetër i shoqërisë, shtetasi J. M., i cili zotëron 34 % të kuotave të kapitalit, ka qenë gjithashtu në rrethanat e një marrëdhënieje të posaçme, pasi bashkëshortja e tij është teza e subjektit dhe vajza e xhaxhait të z. S.Ç., administrator dhe ortak shumice. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës korrespondencën shkresore⁴⁵ të mbajtur me shoqërinë “****” në lidhje me këtë çështje.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

34. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pranë Komisionit dhe në seancën dëgjimore, vlerëson se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, si dhe paraqiti shpjegime bindëse për sa i përket pagesës së kështit të parë prej 30,000 eurosh, brenda datës 15.5.2009.

34.1. Në lidhje me huan prej 30,000 eurosh dhënë nga shoqëria “****” sh.p.k., babait të subjektit, Komisioni konstaton se në deklaratën noteriale të datës 30.4.2009 paraqitur si provë nga subjekti, citohet se “...shoqëria *** i ka dhënë sot z. N. Sh. një shumë prej 30,000 euro në formën e një huaje pa interes për një periudhë kthimi deri në fund të vitit 2009, me qëllim për tja dhënë djalit të tij për prenotimin e një apartamenti në qytetin Tiranë...”. Nga hetimi rezultoi se brenda datës 15.5.2009, administratori i shoqërisë së ndërtimit ka depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë pranë “NBG Bank” shumën 30,000 euro me përshkrimin “*Dep për blerje apartamenti nr *** kati ***, teknik Erion Shehaj*”. Nga analizimi i veprimeve të lidhura me njëra-tjetrën, vihet re përputhja në kohë e tyre, me qëllim pagesën e kështit të parë prej 30,000 eurosh si kusht për porositjen e apartamentit.

34.2. Huaja e dhënë nga shoqëria e mësipërme vërtetohet me deklaratën noteriale të kohës, e cila i jep vlerë provuese pretendimit të subjektit në lidhje me burimin e pagesës së kështit të parë për blerjen e apartamentit. Subjekti gjithashtu arriti të provonte me dokumentacion ligjor provues burimin e krijimit të shumës së dhënë nga shoqëria me xhiron e aktivitetit tregtar, për periudhën e përcaktuar 1 janar -30 prill të vitit 2009.

34.3. Referuar dokumentacionit në lidhje me shoqërinë “****” rezulton se subjekti tregtar është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datën 16.10.1997, me objekt aktiviteti në fushën e ndërtimit dhe import-eksporteve. Kapitali i saj është në vlerën 80,069,567 lekë, i cili zotërohet nga dy ortakë, z. S. Ç. me 66% të pjesës takuese në këtë kapital dhe z. J. M. me 34% të kapitalit.

34.4. Nga analizimi i dokumentacionit ligjor⁴⁶, në lidhje me volumin e aktivitetit tregtar të deklaruar në organin kompetent tatimor evidentohet se shoqëria “****” ka realizuar një xhiro prej 9,587,320 lekësh në periudhën janar - prill 2009 dhe xhiro vjetore prej 127,386,052 lekësh. Fitimi i tatueshëm vjetor i rezultuar për këtë shoqëri në vitin 2009 ka qenë në vlerën 13,237,163 lekë. Gjithashtu, nga verifikimi i ekstraktit të llogarisë së shoqërisë “****” në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 8.1.2009-24.4.2009 rezulton se janë kryer veprime tërheqje *cash* nga llogaria e shoqërisë, në shumën totale 12,500,000 lekë, likuiditete të cilat justifikojnë mjaftueshëm shumën e dhënë hua prej 30,000 eurosh.

34.5. Për sa i përket kthimit të kësaj huaje, rezultoi se ajo është kthyer brenda vitit 2009, bazuar në deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr.*** kol., datë 2.1.2022, të lëshuar nga shoqëria “****”, e cila mori cilësinë e provës në procesin administrativ të rivlerësimit të kryer për subjektin e rivlerësimit.

⁴⁵ Kërkesë për informacion nga Erjon Shehaj dhe kthim përgjigjeje nga shoqëria “****”.

⁴⁶ Shkresë me nr. *** prot, datë 15.3.2022, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sarandë.

34.6. Trupi gjykues vlerësoi edhe në lidhje me burimet që i kanë shërbyer subjektit për shlyerjen e huas prej 30,000 eurosh ndaj shoqërisë “***”. Në këtë kontekst, trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin provues në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj huaje nga subjekti i rivlerësimit, i vlerësoi ato bindëse për sa provohen me dokumentacion ligjor të kohës, për krijimin e tyre si burim.

34.7. Nga analiza e shpjegimeve të subjektit, në raport me faktet dhe dokumentacionin provues në lidhje me to, krijohet bindja se shuma prej 30,000 eurosh është shlyer me huan e dhënë nga babai i subjektit në vlerën 2,500,000 lekë, sipas deklaratës noteriale të datës 16.09.2009 dhe me kredinë e marrë pranë Bankës Popullore në datën 2.10.2009, pra pjesën e mbetur të kredisë në shumën 1,750,000 lekë, pas pagesës së kësaj të dytë të trajtuar më poshtë në këtë vendim, kredi e cila rezulton e tërhequr plotësisht deri në datën 31.12.2009.

34.8. Të gjitha veprimet e konstatuara përgjatë vitit 2009 kanë qenë koherente dhe i krijojnë trupit gjykues bindjen se huaja prej 30,000 eurosh i është shlyer/kthyer shoqërisë “*****” sh.p.k., brenda datës 31.12.2009, pra brenda periudhës së vitit financiar, me qëllim që shoqëria të mbyllte bilancin vjetor të vitit 2009.

34.9. Komisioni, duke u mbështetur edhe në provueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi bindëse dhe të faktuara shpjegimet e tij. Në kuadër të hetimit të Komisionit, subjekti paraqiti një sërë aktesh shkresore noteriale dhe dokumente financiare, të cilat ndërlidheshin ndërmjet tyre.

34.10. Në lidhje me burimet që i kanë shërbyer babait të subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës 2,500,000 lekë dhënë hua në datën 16.09.2009, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni për të justifikuar burimet e ligjshme të krijimit, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pas paraqitjes së shpjegimeve dhe provave nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i gjeti ato bindëse.

34.11. Nga analizimi i dokumentacionit ligjor të paraqitur nga subjekti provohet se në datën 12.9.2009 babai i subjektit të rivlerësimit i ka marrë hua kushëritit të tij, z. S.N., një shumë prej 1,500,000 lekësh, pa interes, për një periudhë të pacaktuar për kthimin e saj, sipas një deklarate noteriale⁴⁷ të nënshkruar nga z. S. N. dhe z. N. Sh. në kohën e marrjes së saj. Sipas kësaj deklarate citohet se babai i subjektit do ta përdorë huan e marrë bashkë me kursimet e tij të mbledhura ndër vite, për t’ia dhënë subjektit të rivlerësimit, me qëllim likuidimin e një apartamenti të porositur prej tij në Tiranë. Më tej, Komisioni ka verifikuar⁴⁸ edhe regjistrimin e kësaj deklarate noteriale në regjistrat noterialë publikë, sipas të cilit noteri publik ka informuar⁴⁹ në lidhje me regjistrimin e deklaratës në regjistrin noterial të kohës, duke dërguar kopje të njësuar të regjistrit të akteve dhe veprimeve noteriale, ku evidentohet e regjistruar edhe deklarata noteriale e datës 12.9.2009. Si përfundim, nga analizimi i veprimeve të kryera në lidhje me marrjen e huas të babait të subjektit nga z. S. N., për t’ia dhënë në vijim subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës prej 2,500,000 lekësh, krijohet bindja se ato janë të ndërlidhura në kohë me njëra-tjetrën. Gjithashtu, provohet me deklaratë të kohës se huaja e dhënë subjektit të rivlerësimit në shumën prej 2,500,000 lekësh ka pasur burim krijimi të ardhurat e marra hua nga z. S. N. në shumën prej 1,500,000 lekësh, si dhe kursimet e z. N. Sh..

⁴⁷Deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.9.2009.

⁴⁸Nëpërmjet informacionit shkresor pjesë të hetimit administrative.

⁴⁹Me shkresën dërguar nga noteri M. M., protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 28.12.2021.

34.12. Trupi gjykues analizoi mbi mundësitë financiare të z. S.N.për të dhënë hua babait të subjektit shumë si më sipër. Në analizën e kryer u konsiderua dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të huas, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016. Referuar akteve të administruara konstatohet se S. N. është regjistruar si person fizik me datën 18.3.2004, me objekt aktiviteti “*tregti të artikujve ushqimorë etj*” në Gjirokastrë. Në lidhje me të ardhurat e realizuara për të cilat janë paguar detyrimet, është vlerësuar dokumentacioni i lëshuar nga organet tatimore, ku referuar shkresës me nr. *** prot., datë 20.1.2021, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, si dhe shkresës me nr. *** prot., datë 29.12.2020, lëshuar nga Bashkia Gjirokastrë konstatohet se: (i) për vitin 2004, ka realizuar qarkullim në shumën 2,500,000 lekë, për të cilin është paguar plotësisht tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe taksa vendore për vitin 2004; (ii) për vitin 2005 ka realizuar qarkullim në shumën 3,281,600 lekë për të cilin është paguar tatimi pjesor i thjeshtuar mbi fitimin, si dhe taksa vendore për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005; (iii) për vitin 2006 ka realizuar qarkullim në shumën 5,389,000 lekë; ndërsa në lidhje me pagesën e taksave vendore; për vitin 2002⁵⁰ ka likuiduar detyrimet e taksave vendore në shumën 12,500 lekë; (iv) për vitin 2003 ka likuiduar detyrimet e taksave vendore në shumën 16,000 lekë; për vitin 2006 ka likuiduar detyrimet e taksave vendore në shumën 56,540 lekë; (v) për vitin 2007 qarkullimi i deklaruar 6,8 milionë lekë dhe detyrimet e taksave vendore të paguara në shumën 83,540 lekë; (vi) për vitin 2008 qarkullimi i deklaruar 7,1 milionë lekë dhe detyrimet e taksave vendore të paguara në shumën 186,440 lekë. Gjithashtu, sipas informacionit të siguruar nga organet tatimore rezulton i çregjistruar si person fizik në datën 27.5.2010.

34.12.1. Për të provuar mundësitë financiare të z. S. N., subjekti paraqiti edhe dy kontrata shitblerjeje të pasurive të paluajtshme, sipas të cilave dokumentohet përfitimi i të ardhurave si individ në shumën prej 2,500,000 lekësh në total. Konkretisht, me kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.5.2000, S. N. u ka shitur shtetasve A. dhe A. A. pasurinë “apartament”, me sip. 140 m² kundrejt çmimit 2,000,000 lekë, ndërsa referuar kontratës së shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.1999 i ka shitur shtetasit R. K. një apartament me sip. 158 m² kundrejt çmimit 500,000 lekë, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

34.12.2. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur në lidhje me z. S. N. duket se ai ka realizuar qarkullim vjetor të konsiderueshëm deri në vitin 2008. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e shitblerjes së pasurive të paluajtshme, ka realizuar të ardhura si individ, në vlerën 2,500,000 lekë, për të cilat janë paguar detyrimet përkatëse tatimore dhe duket se këto të ardhura kanë qenë të mjaftueshme për t'i dhënë z. N. Sh. huan në shumën 1,500,000 lekë.

34.13. Më tej, nga analizimi i të ardhurave nga pagat e prindërve të subjektit për periudhën 1 janar 1998 - 16 shtator 2009 në shumën 4,317,000 lekë, pas zbritjes së shpenzimeve jetike për të njejtën periudhë, në vlerën rreth 2,602,000⁵¹ lekë, mundësia e tyre për të kursyer rezultoi rreth 1,714,000 lekë, të ardhura të cilat janë mjaftueshme për të mbuluar vlerën prej 1,000,000 lekësh, si burim krijimi i huas së dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij në shumën 2,500,000 lekë. Pra, nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, si dhe nga hetimi i Komisionit provohen burimet e krijimit për shumën e mësipërme, dhënë hua nga babai.

⁵⁰ Informacion i siguruar me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2020, paraqitur si provë nga subjekti.

⁵¹ Shpenzimet jetike janë përlllogaritur sipas ILDKPKI-së pr 2 persona; përkatësisht për periudhën 2000 - 2009 sipas ILDKPKI-së, ndërsa për vitet 1998-1999, sipas shpenzimeve të vitit 2000, sipas informacionit të ILDKPKI-së me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019.

34.14. Për sa i përket deklaramit të huas prej 30,000 eurosh, dhënë nga shoqëria “****”, trupi gjykues vlerëson se subjekti me të drejtë nuk e ka deklaruar këtë hua si detyrim në deklaratën e pasurisë së vitit 2009, pasi huaja në shumën 30,000 euro rezultoi e marrë dhe e kthyer brenda vitit. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson gjithashtu se me të drejtë subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009 si detyrim të këtij viti huan e marrë nga babai i tij në shumën 2,500,000 lekë, për sa kjo hua rezultoi e marrë në këtë vit dhe e pashlyer, duke deklaruar gjendjen e këtij detyrimi për këtë vit dhe në deklaratat periodike vijuese shumën e mbetur të detyrimit.

34.15. Bazuar në faktet, provat e analizuara më lart, si dhe legjislacionin në fuqi, trupi gjykues vlerëson se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, duke provuar pagesën e kështit të parë prej 30,000 euro brenda datës 15.5.2009, me burime të dokumentuara dhe të ligjshme.

B) Në lidhje me kështin e dytë në vlerën 15,600 euro

35. Në kontratën e sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.5.2009, është përcaktuar⁵² se çmimi prej 48,000 euro, do të paguhet me këste, sipas të cilit: (i) kësti i parë prej 30,000 euro, i cili rezultoi i paguar brenda datës 15.5.2009; dhe (ii) kësti i dytë do të paguhet në vlerën prej 18,000 eurosh deri në momentin e dorëzimit të apartamentit.

35.1. Në vijim, ka rezultuar se me deklaratën noteriale⁵³ të datës 7.10.2009, shtetasi Y. Z., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “*****” sh.p.k dhe subjekti i rivlerësimit kanë deklaruar se: *“Ne të dy deklaruesit e mësipërm kemi lidhur një kontratë sipërmarrje me nr. *** rep dhe *** kol datë 07.05.2009 për pasurinë e paluajtshme apartament banimi prej 75 m2 në Rr *** në shumën prej 48,000 euro. Unë Y. Z. mora sot në prezencë të noteres nga Erjon Shehaj nga kësti i dytë prej 18,000 euro vetëm shumën prej 15,600 euro si këst të dytë, shumë për të cilën nuk kam asnjë pretendim. Gjithashtu, jam dakord që pjesën e ngelur nga kësti i dytë prej 2,400 euro z. Shehaj do ma likujdojë me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës sipas ligjit. Edhe unë Erjon Shehaj jam dakort me të gjitha sa u thanë më sipër”*. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paguar vetëm shumën 15,600 euro nga kësti i dytë i përcaktuar në vlerën 18,000 euro.

35.2. Në lidhje me burimet e krijimit për pagesën e shumës 15,600 euro, Komisioni u bazua në deklaramin e subjektit në deklaratën “Vetting” se një nga burimet e krijimit të pasurisë ka qenë dhe kredia e marrë në Bankën Popullore, në shumën 4,000,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar konstatohet se në datën 6.10.2009 është disbursuar kredia pranë kësaj banke në shumën 4,000,000 lekë dhe në të njëjtën ditë subjekti ka tërhequr shumën 2,200,000 lekë. Më tej vërehet se në datën 7.10.2009 është paguar shuma 15.600 euro si këst i dytë, e cila konvertuar në lekë⁵⁴, ekuivalentohet në shumën 2,140,000 lekë, afërsisht sa shuma e tërhequr.

35.3. Si përfundim, nga analiza e transaksioneve të kryera në koherencë me njëra-tjetrën, si dhe pas shpjegimeve të subjektit, rezultoi se kësti i dytë në shumën 15,600 euro është paguar me kredinë pranë Bankës Popullore, (sot “OTP Bank”) të marrë nga subjekti dhe personi i lidhur me të. Gjithashtu, nga analizimi i dokumentacionit të kredisë nuk u konstatuan problematika.

⁵² Neni 2 i kontratës.

⁵³ Deklarata noteriale për shlyerje detyrimi të pjesshëm me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2009, aneksi 4/2 i ILDKPKI-së, faqe ***.

⁵⁴ Referuar kursit zyrtar mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë në vitin 2009, me burim faqen zyrtare të BSH-së: <https://www.bankofalbania.org/>

C) Në lidhje me këstin e tretë në vlerën 13,500 euro

36. Referuar DIPP/2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka revokuar kontratën e sipërmarrjes datë 7.5.2009 dhe ka lidhur kontratën për premtim shitjeje⁵⁵ datë 14.1.2014 për apartamentin me sip. 94 m² në total, në vlerën 13,500 euro, si dhe ka deklaruar hua të marrë në vlerën 14,000 euro nga babai i tij.

36.1. Nga administrimi i dokumentacionit për blerjen e apartamentit, sikundër është trajtuar më lart, është konstatuar se çmimi prej 62,000 euro është paguar sikurse vijon: një pjesë sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 7.5.2009, pra shuma 45,600 euro, ndërsa shuma 13,500 euro është likuiduar në datën e lidhjes së kontratës; kësti i fundit në shumën prej 2,900 euro (2,400 euro nga apartamenti i parë dhe 500 euro nga apartamenti i dytë) do të paguhej nga subjekti me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes.

Burimi i krijimit të shumës prej 13,500 eurosh

37. Në DIP/2013 subjekti ka deklaruar: “...Hua e marrë në vlerën 14,000 euro sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë 15.11.2013...”.

37.1. Në DIP/2014 subjekti ka deklaruar: “... Shuma 13,500 euro...”...Me kontratën nr. ***rep., nr. *** kol., datë 14.01.2014 është revokuar kontrata e sipërmarrjes me nr ***rep dhe *** kol., datë 07.05.2009 e lidhur mes Erjon Shehaj dhe “***” shpk. Me këtë kontratë tashmë është bërë premtim shitblerje të një apartamenti 84 m² + 10 m² sip e përbashkët dhe anuluar gjithçka e përcaktuar në kontratën e mëparshme...”... “...Hua e marrë në vlerën 14,000 euro sipas deklaratës noteriale nr *** rep., nr *** kol datë 15.11.2013....gjendja e mbetur e detyrimit 14,000 euro...”.

37.2. Në lidhje me huan prej 14,000 euro, subjekti ka sqaruar gjatë hetimit administrativ⁵⁶ se “...Përmes deklaratës noteriale të datës 15.11.2013, kam marrë hua një shumë prej 14,000 euro nga babai im N. Sh. Këtë hua e kam marrë duke mos përcaktuar afate për kthimin e saj. Aktualisht kjo hua është e pakthyer ndaj babait tim. Qëllimi i marrjes së kësaj huaje ka qënë pagesa e diferencës së çmimit nga apartamenti që do të prenotoja (premtim shitje) në vitin 2014 kundrejt çmimit që kisha paguar nga prenotimi i apartamentit në vitin 2009...”.

37.3. Komisioni administroi deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2013, lëshuar nga babai i subjektit z. N. Sh., sipas të cilit ka deklaruar se: “Unë shtetasi N. Sh. deklaroj me vullnetin dhe përgjegjësinë ligjore se i kam dhënë hua djalit tim Erjon Shehaj një shumë prej 14,000 euro i cili do të përdorë për blerjen e shtëpisë në qytetin e Tiranës. Deklaroj se shtetasi Erjon Shehaj ka marrë në dorëzim shumën e huasë prej 14,000 euro”.

37.4. Më tej, nga verifikimi i deklaratave vjetore të vitit 2013 të subjektit dhe personit të lidhur me të, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP/2013 në lidhje me gjendjen e likuiditeteve/cash të disponuara deri në datën 31.12.2013, fakt për të cilin iu kërkuan shpjegime.

Analiza e burimeve të krijimit të shumës prej 14,000 eurosh

38. Në lidhje me burimin e krijimit të shumës së dhënë hua nga babai, subjekti ka bashkëlidhur deklaratën “Vetting” disa akte, të cilat janë trajtuar në seksionin e huas prej 2,500,000 lekësh, dhënë po nga babai i tij. Gjithashtu, ka depozituar në pyetësorin e dytë

⁵⁵ Kontratë premtim shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.1.2014 aneksi *** e ILDKPKI-së, faqe ***.

⁵⁶ Përgjigjet e pyetësorit nr. 1, dërguar nga subjekti.

disa akte provuese mbi mundësitë financiare të prindërve të tij, të cilat janë vlerësuar nga Komisioni në kuptim të analizës së burimeve të krijimit të huas së dhënë nga babai i tij, në vlerën 14,000 euro.

38.1. Komisioni i ka administruar dhe analizuar aktet e paraqitura nga subjekti, nga ku duket se referuar pagave të prindërve nga muaji tetor 2009, pra pas periudhës në të cilën është pretenduar dhënia e huas së parë në vlerën 2,500,000 lekë, deri në muajin nëntor 2013, pra kur është dhënë huaja e dytë, të ardhurat e përfituara kanë qenë në vlerën rreth 3,711,000 lekë, për të cilat pasi zbriten shpenzimet jetike për dy persona⁵⁷ në vlerën rreth 1,157,000 lekë për të njëjtën periudhë, mundësia për të kursyer do të ishte maksimalisht në shumën rreth 2,553,000 lekë.

38.2. Nga analiza financiare e përgatitur nga Komisioni në datën e pagesës, datë 14.1.2014, referuar deklaratës noteriale të kësaj date, të nënshkruar nga subjekti dhe shitësi, subjekti rezultoi në pamundësi financiare për të shlyer këstin e tretë prej 13,500 euro me të ardhurat nga paga e tij dhe personit të lidhur me të, pasi Komisioni e konsideroi me rezervë huan e dhënë nga babai i tij, për sa subjekti nuk e ka deklaruar në DIPP/2013 në formën e likuiditeteve/ gjendje *cash*.

38.3. Për sa më lart, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, për të provuar dhe shpjeguar në lidhje me huan e marrë në shumën 14,000 euro, mosdeklarimin e likuiditetit nga huaja e marrë në DIPP/2013, justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave për shumën e dhënë hua nga babai i tij, si dhe pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të justifikuar pagesën e këstit të tretë prej 13,500 eurosh, për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

39. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se huan e marrë nga babai i tij me deklaratën noteriale të datës 15.11.2013, nuk e ka përdorur në vitin 2013, pasi kjo hua është marrë për qëllimin e pagesës së shtëpisë së re që do të ndërrohej me shitësin, e cila u bë e mundur në janar të vitit 2014 (pasi deri në atë moment jetonin familjarët e shitësit). Ai ka sqaruar se nuk e ka poseduar shumën e marrë hua nga babai dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme babë - bir, ka gjykuar që këtë vlerë monetare ta mbante në shtëpinë e babait në Sarandë (për periudhën 15 nëntor 2013 - 14 janar 2014).

39.1. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se deklarimi në DIP/2013 ka qenë i saktë, pasi ka deklaruar detyrimin që ka sipas deklaratës noteriale të vitit 2013 dhe në vijim, në janar të 2014 e ka marrë në dorëzim shumën kur ka lidhur dhe kontratën për premtim shitjeje, të cilën ia ka paguar shitësit.

39.2. Në lidhje me mundësitë financiare të babait të tij për t'i dhënë hua subjektit, ka sqaruar se dokumentacioni i depozituar në Komision në lidhje me të ardhurat e prindërve të tij provon se ata kanë pasur mundësi t'i japin atij hua. Subjekti ka theksuar se përveç të ardhurave të realizuara nga punësimi i prindërve, ata kanë përdorur edhe shumat në vlerën 400,000 lekë dhe 200,000 lekë, të cilat subjekti ua ka kthyer atyre përkatësisht në vitet 2011 dhe 2012, në kuadër të huas së dhënë më parë babait të tij në shumën prej 2,500,000 lekësh, shlyerjet e të cilave i ka deklaruar në deklaratat përkatëse të pasurive.

39.3. Në përfundim, subjekti ka kërkuar që të konstatohet saktësi në deklaram, si dhe të konsiderohet huaja e dhënë nga babai i tij me të ardhura të ligjshme, si burim për pagesën e këstit të tretë.

⁵⁷ Shpenzimet jetike për 2 persona janë përllogaritur sipas informacionit të ILDKPKI-së me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

40. Trupi gjykues pasi administroi shpjegimet e subjektit në lidhje me pagesën e këstit të tretë të çmimit të apartamentit, i vlerësoi ato bindëse. Nga analizimi i veprimeve juridike të kryera me qëllim shlyerjen e pagesës së këstit të tretë, vihet re se ato janë të lidhura ngushtësisht në kohë me njëra tjetrën. Pra, në datën 15.11.2013 është nënshkruar deklarata noteriale në lidhje me huan në shumën prej 14,000 eurosh, dhënë subjektit nga babai i tij dhe në datën 14.1.2014 është lidhur kontrata për premtim shitjeje midis subjektit dhe palës shitëse, në zbatim të së cilës është paguar shuma prej 13,500 eurosh nga subjekti para noterit publik.

40.1. Në lidhje me mosdeklarimin në DIPP/2013 nga subjekti të gjendjes së likuiditeteve prej 14,000 euro nga huaja, sipas deklaratës noteriale të datës 15.11.2013, trupi gjykues vlerëson se nga analizimi i shpjegimeve të subjektit në lidhje me mospasjen në posedim të kësaj shume, në raport me faktet e rezultuara në vijim nga analizimi i provave për pagesën e këstit të radhës në shumën 13,500 euro, duket se ato janë bindëse. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion, duke konsideruar edhe faktin se subjekti nuk e ka fshehur këtë hua, por e ka deklaruar në DIPP/2013 në seksionin e detyrimeve financiare. Më tej në DIPP/2014 ka deklaruar ndryshimin e të drejtave reale sipas kontratës për premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.1.2014.

40.2. Në lidhje me burimet e krijimit për huan e dhënë nga babai i tij në shumën 14,000 euro, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në deklaratën “Vetting”, lidhur me të ardhurat e përfituara nga prindërit e subjektit për periudhën pas dhënies së huas së parë, pra nga data 17.9.2009 - 15.11.2013, ku rezulton se të ardhurat nga pagat për këtë periudhë kanë qenë në vlerën 3,711,380 lekë, nga të cilat i zbriten shpenzimet jetike në shumën 1,157,666 lekë, të përlllogaritura për të njëjtën periudhë, duke rezultuar me mundësi kursimi në vlerën 2,553,714 lekë.

40.3. Në kuadër të analizës së kryer pas kalimit të barrës së provës në lidhje me mundësitë financiare të prindërve të subjektit për të dhënë hua në shumën 14,000 euro, trupi gjykues vlerësoi të bazuar pretendimin e subjektit se në këtë analizë duhet të përfshihen edhe shumat e kthyer babait të tij, si detyrim nga huaja e parë prej 2,500,000 lekësh, përkatësisht në vitin 2011 në shumën 400,000 lekë dhe në vitin 2012 në shumën 200,000 lekë, të cilat janë deklaruar në DIPP/2011 dhe DIPP/2012. Për rrjedhojë, në analizën financiare në lidhje me të ardhurat e prindërve të subjektit, u konsiderua edhe shuma 600,000 lekë kthyer babait të tij nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 dhe 2012.

40.4. Në përfundim të analizës financiare për të ardhurat e dokumentuara nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se prindërit e tij kanë pasur mundësi kursimi prej 3,153,714 lekësh, për periudhën 17.9.2009 - 15.11.2013, të cilat kanë qenë të mjaftueshme për krijimin e shumës 14,000 euro (konvertuar në 1,961,540 lekë), dhënë hua subjektit të rivlerësimit për pagesën e këstit të radhës në shumën 13,500 euro, me qëllim blerjen e apartamentit objekt vlerësimi.

40.5. Nga analiza e fakteve, trupi gjykues konkludon se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pagesën e këstit prej 13,500 euro me burim nga huaja në shumën 14,000 euro dhënë nga babai i tij dhe se nga analiza e të ardhurave të prindërve të subjektit, rezultoi se ata kishin mundësi financiare t'i jepnin subjektit këtë hua.

41. Pasuria e llojit “automjet”, blerë me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2016, nga shtetasi A. K., tip “***”, me targa ***, ngjyrë ***, prodhim i vitit

2005. Vlera 300.000 lekë; 100% pjesë takuese. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhura të kursyera nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

41.1. DPSHTRR-ja⁵⁸, konfirmon regjistrimin e automjetit të mësipërm në emër të subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se në datën 12.10.2016, automjeti është zhdoganuar nga shtetasi A. K., ku është deklaruar vlera prej 900 euro e blerë prej tij në Gjermani dhe janë paguar detyrimet doganore në shumën 73,234 lekë. Në vijim, në datën 15.11.2016, subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin nga ky shtetas me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2016, kundrejt vlerës 300,000 lekë. Në datën 23.11.2016, subjekti i rivlerësimit është pajisur me certifikatë pronësie mbi automjetin.

41.2. Nga hetimi rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.

Analiza e burimit të krijimit të pasurisë

42. Nga verifikimi i deklaratës “Vetting” dhe DIPP/2016 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë, të ardhurat e kursyera nga paga e tij dhe e personit të lidhur me të.

42.1. Komisioni përgatiti analizën financiare për periudhën 1.1.2016–15.11.2016, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për kryerjen e pagesës në shumën prej 300,000 lekësh për blerjen e automjetit të markës “***”.

42.2. Nga analiza financiare e kryer, subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e automjetit, në datën e blerjes në shumën - 359,967 lekë dhe për vitin 2016 në shumën - 696,478 lekë. Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

43. Subjekti ka shpjeguar se i qëndron deklaramit të tij të kryer në DIPP/2016 dhe në deklaratën “Vetting” se për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer kursimet e tij dhe të bashkëshortes të krijuara deri në atë periudhë. Por, ai ka theksuar se në analizën financiare për blerjen e automjetit, si dhe atë vjetore, duhet konsideruar mënyra e deklaramit të gjendjes *cash* prej tij pasi, sipas subjektit, është deklaruar gjendja *cash* në banesë në datën 31 dhjetor të çdo fundviti. Në këtë mënyrë, duke konsideruar se në fund të vitit është deklaruar gjendje *cash*, rrjedhimisht ndryshon edhe analiza financiare në datën e blerjes së automjetit, si dhe ajo vjetore, duke rezultuar me balancë pozitive.

43.1. Subjekti ka theksuar se nuk ka pasur në asnjë vit gjendje të kursyer nga një vit më i hershëm. Kjo mënyrë deklarimi është e qartë prej tij deri në vitin 2017, kurse në deklaratat vijuese të pasurive, subjekti ka shpjeguar se ka deklaruar vlerën e shtuar në atë vit në vijim të vitit paraardhës, si dhe totalin e gjendjes së arrirë në fund të vitit, duke cituar deklaramin e tij të kryer në vitin 2019 dhe të bashkëshortes së tij në vitin 2020. Subjekti ka shpjeguar se, nëse do të ishte i vërtetë fakti i deklaramit të shtesave vjetore të *cash*-it, atëherë gjendja e akumuluar deri në vitin 2013 do të ishte 2,130,000 lekë, që do ta bënte të panevojshme marrjen e një huaje nga babai i tij në vlerën 14,000 euro dhe se, nëse kursimet e krijuara prej tij do ishin të akumuluar, atëherë edhe në vitin 2016 dhe 2017 do të kishte pasur mundësi të shlyente huan ndaj babait të tij në atë periudhë dhe jo të mbante huan të pashlyer dhe 4-5 vite të tjera.

⁵⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 21.1.2021.

43.2. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu ka kundërshtuar mënyrën e përlllogaritjes së analizës financiare mbi mundësinë për blerjen e automjetit në nëntor të vitit 2016. Ai ka theksuar se në dritën e sqarimeve të dhëna prej tij për deklaratimet në vite të gjendjes *cash*, shuma 350,000 lekë e deklaruar prej tij në vitin 2016, nuk është shtesë në gjendjen e *cash*-it, por është gjendja e likuiditeteve në fund të vitit 2016, duke bërë që në total shtesa për këtë vit të jetë në shumën 50,000 lekë *cash*, krahasuar me deklarimin e vitit të mëparshëm në shumën 300,000 lekë.

43.3. Subjekti ka shpjeguar se në analizën financiare për blerjen e automjetit, Komisioni ka përfshirë si shpenzim të kryer deri në datën 15.11.2016, shumën 200,000 lekë, deklaruar në DIPP/2016, si shumë të kthyer babait të tij nga huaja e marrë në vitin 2009 prej 2,500,000 lekësh. Shuma e deklaruar në DIPP/2016 nuk duhet të përfshihet e plotë në analizën financiare të datës 15.11.2016 për blerjen e automjetit, pasi deri në nëntor të vitit 2016 (në periudhën e blerjes së automjetit) ka shpjeguar se i ka kthyer babait një pjesë të huas, pra vetëm shumën 100,000 lekë dhe në dhjetor të atij viti i ka kthyer pjesën tjetër prej 100,000 lekë. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe disa kundërshtime për analizën financiare të vitit 2016, të cilat janë përfshirë në seksionin e analizës financiare për periudhën 2008-2016.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

44. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimet, si dhe mundësitë financiare të tij dhe të bashkëshortes për blerjen e automjetit në datën 15.11.2016, i vlerësoi ato bindëse.

44.1. Nga analizimi i shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht se nuk ka deklaruar saktësisht likuiditetet në banesë, sikurse është kërkuar, i ka deklaruar ato si gjendje të disponuara në fund të vitit, duke paraqitur për rrjedhojë një situatë financiare të përfaqësuar nga gjendja totale e disponuar në fund të vitit, në raport me gjendjen e deklaruar të një viti më parë. Trupi gjykues vlerëson se kjo pasaktësi, e pranuar nga vetë subjekti me shpjegimet e tij, nuk e penalizon atë në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

44.2. Në këtë logjikë, në analizën financiare të vitit 2016⁵⁹, si dhe në atë të datës së blerjes së automjetit, është konsideruar pretendimi i subjektit në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash* të disponuar në banesë në fund të vitit. Për rrjedhojë, situata financiare e gjendjes *cash* në DIPP/ 2016, e deklaruar nga subjekti në shumën 350,000 lekë ka ndryshuar (pra, është shtuar në këtë vit) me vlerën 50,000 lekë në raport me gjendjen e *cash*-it, të deklaruar nga subjekti në DIPP/2015, në shumën 300,000 lekë.

44.3. Trupi gjykues, pasi administroi pretendimet e subjektit në lidhje me ndryshimin e analizës financiare për blerjen e automjetit në zërin “ndryshim likuiditeti” dhe “shpenzim për shlyerje huaje ndaj babait N. Sh.”, i vlerësoi ato të drejta. Në analizën financiare të kryer në datën e blerjes së automjetit, zëri “ndryshim likuiditeti” ka ndryshuar nga vlera 92, 116 lekë në -207,884 lekë, si diferencë e kursimeve të vitit të mëparshëm në shumën 300,000 lekë me gjendjen e likuiditetit të datës 15.11.2016, në shumën 92,116 lekë. Gjithashtu, në këtë analizë, ka ndryshuar edhe zëri i shpenzimeve për shlyerjen e huas ndaj babait të tij, nga shuma 200,000 lekë në shumën 100,000 lekë, për sa subjekti shpjegoi se pjesa tjetër prej 100,000 lekësh i është dhënë babait në muajin dhjetor të vitit 2016.

⁵⁹ E cila paraqitet e integruar në analizën financiare për periudhën 2008-2016 në fund të vendimit.

44.4. Si përfundim, nga analiza financiare e kryer pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mundësi financiare për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit “****”, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 40,033 lekë.

Tabela nr.1.

Analiza financiare në momentin e blerjes së automjetit 1.1.2016-15.11.2016

	15.11.2016
A) PASURI	92,116
Automjet tip “****” me targa ***, ngjyrë ***, prodhim i vitit 2005. Vlera 300.000 lekë, datë 15.11.2016.	300,000
Ndryshim likuiditeti	-207,884
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	92,116
D) TË ARDHURA	1,727,272
Të ardhura nga paga subjekti	979,832
Të ardhura nga paga bashkëshortja	747,440
E) SHPENZIME	1,595,123
Shpenzime minimale jetike	741,989
Shpenzime për shlyerje kredie pranë “OTP BANK”	392,000
Shpenzime për shlyerje huaje ndaj babait N. Sh.	100,000
Shpenzime arsimit për fëmijët	110,000
Shpenzime për udhëtimet jashtë vendit	69,664
Shpenzime shëndetësore	135,270
Shpenzime për udhëtimin në vendin e punës në Lezhë, subjekti	46,200
Balanca e fondeve (D-C-E)	40,033

E drejtë përdorimi automjeti

45. Subjekti ka deklaruar aktpërdorimi automjeti, sipas aktit noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2016, për mjetin tip “****”, me targa ***, në pronësi të shtetasit R. D. (kunati).

Deklarimi në deklaratat periodike vjetore

45.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP/2016 se ka në përdorim automjetin me të dhënat e mësipërme. Deklarimi i së njëjtës rrethanë rezulton të jetë bërë edhe në deklaratën “Vetting”.

Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

46. Nga verifikimi në DPSHTRR⁶⁰ rezulton se mjete i mësipërm, me vit prodhimi 2006, është blerë në Gjermani nga shtetasi R. D., në vlerën 300,000 lekë, referuar deklaratës doganore të datës 21.1.2015, si dhe është paguar zhdoganimi nga ky shtetas në shumën 197,200 lekë.

46.1. Me kontratën e shitblerjes⁶¹ të datës 15.3.2015, mjete i është shitur shtetasit G. Z. (i cili nga verifikimi në regjistrat e gjendjes civile duket se është djali i motrës së bashkëshortes së subjektit) kundrejt çmimit 8,000 euro.

46.2. Në vijim, me kontratën e shitjes⁶² së datës 29.10.2016, automjeti kalon në pronësi të shtetasit R. D. (kunati i subjektit), kundrejt çmimit 400,000 lekë. Shtetasi R. D., në të njëjtën ditë me blerjen e automjetit, lëshon një aktpërdorimi⁶³ me nr. *** rep., nr. ***kol, në të cilin deklaron se këtë automjet ia lë në huapërdorim për afat 5-vjeçar subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për udhëtime brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

46.3. Me kontratën e shitjes⁶⁴ datë 16.2.2017, automjeti i shitet shtetasit A. L., kundrejt çmimit 2000 euro.

46.4. Nga hetimi i kryer në sistemin *TIMS*⁶⁵, rezulton se gjatë vitit 2015 subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë automjet për të udhëtuar jashtë shtetit shqiptar, nga pika kufitare në Murriqan, në datat 28.11.2015 - 30.11.2015, pra, para lëshimit të aktpërdorimit, kur automjeti ka qenë në pronësi të shtetasit G.Z. Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është shënuar si përdorues edhe në policën e sigurimit të tipit “Karton jeshil” për këtë automjet, e vlefshme për periudhën 27.11.2015 - 11.12.2015.

46.5. Referuar të dhënave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit është shënuar si përdorues në policat e sigurimit të këtij automjeti, të tipit “TPL” – për periudhat si vijon: 1) nga data 27.11.2015 –26.11.2016; (pronar shtetasi G. Z.); 2) nga data 2.12.2016 - 1.12.2017; (pronar shtetasi R.D.) dhe në vijim në datën 17.02.2017 shtetasi A.L.ka marrë duplikatë të policës si pronar. Nga administrimi i dokumentacionit duket se në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” (26.1.2017), subjekti i rivlerësimit e ka patur policën e sigurimit të vlefshme për këtë automjet. Më tej, janë verifikuar në sistemin TIMS, hyrje - daljet për pronarët e automjetit, G. Z. dhe R. D., nga ku duket se këta shtetas nuk kanë lëvizur me këtë automjet.

46.6. Pas vlerësimit të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, në lidhje me dyshimin për fshehje të pronësisë së automjetit për sa nga hetimi, u konstatuan këto fakte: (i) transaksione të njëpasnjëshme për kalimin e pronësisë mbi këtë automjet midis të afërmeve të bashkëshortes së subjektit brenda një periudhe kohore të shkurtër; (ii) blerja e automjetit kundrejt çmimit 400,000 lekë nga shtetasi R.D. në datën 29.10.2016 dhe, në të njëjtën datë, dhënia në huapërdorim e automjetit subjektit të rivlerësimit; (iii) lidhja e policës së sigurimit, si dhe përdorimi i automjetit nga subjekti i rivlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

⁶⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021 dhe kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021.

⁶¹ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol.

⁶² Kontratë shitjeje me nr. *** rep, nr. kol është i paqartë.

⁶³ Depozituar bashkë me deklaratën “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit

⁶⁴ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol.

⁶⁵ Dërguar me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2021.

47. Subjekti ka shpjeguar si fillim se përdorimi i këtij automjeti ka ndodhur në funksion të marrëdhënieve të posaçme, ku janë kryer disa veprime juridike midis tyre. Ai ka shpjeguar se deri në blerjen e automjetit, në datën 15.11.2016, nuk ka pasur automjet dhe për kryerjen e nevojave apo për lëvizje jashtë Shqipërisë, ka përdorur shërbimin e transportit publik që mundësohej nga agjencitë e udhëtimit. Më tej ka sqaruar se automjetin e mësipërm e ka përdorur vetëm një herë për një udhëtim dyditor jashtë Shqipërisë, në Kroaci dhe, më pas nuk e ka përdorur asnjëherë. Për këtë qëllim, duke qenë se automjeti nuk e kishte të vlefshëm dokumentacionin e nevojshëm për të lëvizur dhe për të shmangur çdo pasojë ligjore, ka qenë i detyruar të presë siguracionin e detyrueshëm “TPL”, si dhe kartonin jeshil për udhëtimin jashtë vendit.

47.1. Më tej, subjekti sqaron se në vitin 2016, kur automjeti ka kaluar në pronësi të kunatit të tij dhe në kushtet kur ai jetonte prej rreth 20 viteve në Itali, ku atje ka në posedim një automjet tjetër për të lëvizur, i ka kërkuar subjektit të kujdesej për të në Shqipëri dhe për këtë qëllim ai i ka lëshuar një aktpërdorimi, i cili është deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë.

47.2. Subjekti ka sqaruar se automjetin në përdorim nuk e ka përdorur, pasi afërsisht pas dy muajsh, ai ka blerë automjetin e tij. Në përfundim, subjekti ka kërkuar që t'i konsiderojë shpjegimet e tij, pasi përfaqësojnë realitetin e çdo veprimi të kryer ai.

47.3. Për të provuar shpjegimet e tij, subjekti paraqiti në cilësinë e provave: deklaratë noteriale e lëshuar nga z. R. D. , apostiluar në datën 23.12.2021, në lidhje me automjetin objekt vlerësimi, si dhe ekstrakt të ardhurash lëshuar nga INPS për R.D. të apostiluar, kopje njësi me origjinalin, lëshuar në datën 3.9.2020.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

48. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit si dhe provat e paraqitura në mbështetje të tyre, vlerëson se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me automjetin të dyshuar si të fshehur. Subjekti arriti të shpjegojë bindshëm në lidhje me dinamikën e posedimit të automjetit sipas aktpërdorimit të lëshuar nga kunati i tij, si dhe përdorimin e tij për një udhëtim jashtë shtetit.

48.1. Nga analiza e fakteve të rezultuara nga dokumentacioni i administruar konstatohet se subjekti deri në nëntor të vitit 2016 nuk ka pasur automjet në pronësi dhe, për rrjedhojë, ka përdorur automjetin e shtetasve, të cilët nga hetimi rezultuan të lidhur në marrëdhënie të posaçme me subjektin e rivlerësimit (vëllai dhe nipi i bashkëshortes së subjektit).

48.2. Në lidhje me përdorimin e automjetit, trupi gjykues vlerëson se në kushtet e mospasjes së një automjeti në pronësi të tij, nevoja e lëvizjes ka diktuar përdorimin e automjetit “****”, me targa ****, të cilin e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2016, si dhe në deklaratën “Vetting”. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit mund ta ketë përdorur automjetin edhe përpara formalizimit me aktpërdorimi, për shkak të lidhjes familjare të subjektit me pronarët e automjetit, por në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ta deklarojë në deklaratat e pasurisë. Detyrimi mbi deklarimin e të drejtave reale mbi pasuritë e luajtshme është përfshirë për herë të parë me ligjin nr. 42/2017, i cili ka hyrë në fuqi më 6.5.2017.

48.3. Trupi gjykues analizoi provat e paraqitura nga subjekti në mbështetje të shpjegimeve. Referuar deklaratës noteriale të datës 23.12.2021, z. R. D. ka deklaruar se është *rezident në Itali bashkë me familjen e tij prej 20 vitesh. Me qëllim përdorimin e një automjeti gjatë periudhës kur kthehej në Shqipëri, ai ka ngarkuar nipin e tij (djalin e motrës) G. Z. për kryerjen e të gjitha procedurave të nevojshme për blerjen, regjistrimin, mirëmbajtjen e automjetit, por për shkak të marrëdhënies së posaçme të lidhur me të, nuk ka gjykuar që të formalizojë porosinë.* Ai ka deklaruar se e ka ndihmuar dhe mbështetur nipin e tij për shkak të rrethanave të veçanta familjare. Më tej në vitin 2016 kur ka formalizuar pronësinë në emrin e tij, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit dhe

bashkëshortes së tij (motra e z. R. D.) që ta mirëmbanin dhe ndërkohë ta përdornin në rast nevojash dhe për këtë arsye u ka lëshuar atyre një aktpërdorimi, në kushtet kur ata janë subjekt deklarues. Automjeti nuk është përdorur shumë dhe për këtë arsye ai ka deklaruar se vendosi ta shiste në fillim të vitit 2017. Referuar ekstraktit të të ardhurave lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore, rajoni “*Reggio nell’Emilia*”, shtetasi R. D.ka realizuar të ardhura mbi të cilat janë paguar kontributet ligjore në shumën 453,571 euro për njëzet vite (2000-2020).

48.4. Nga analiza e provave të paraqitura nga subjekti rezulton se R. D., gjatë viteve 2000-2020 ka punuar në Itali në punë të ndryshme, kryesisht punë bujqësore, nga ku ka realizuar të ardhura në shumën 453,571 euro, të cilat duket se kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar blerjen e automjetit të mësipërm në vitin 2016. Për sa i përket deklarimit të shtetasit R.D. në lidhje me pronësinë e tij mbi automjetin që në vitin 2015, trupi gjykues e administroi në kuptim të barrës së provës të lënë subjektit dhe vlerëson se ky deklarim nuk provohet me dokumentacion ligjor, për sa referuar dokumentacionit për blerjen e automjetit administruar gjatë hetimit të Komisionit, blerësi rezulton shtetasi G. Z. Gjithsesi, ky konstatim nuk ndikon në vlerësimin e përgjithshëm të fakteve për të cilat subjektit i kaloi barra e provës, për sa nga analiza e shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti u arrit të provohej e kundërta e rezultatit të hetimit.

48.5. Trupi gjykues vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit në lidhje me nevojën e përdorimit të përkohshëm të këtij automjeti, për sa nga hetimi u provua se subjekti bleu automjetin e tij në nëntor të vitit 2016 dhe nuk rezultuan indicie të tjera në lidhje me përdorimin e atij automjeti. Për më tepër, bazuar në dokumentacionin e administruar nga hetimi⁶⁶, rezultoi se ky automjet iu shit një shtetasi tjetër në datën 16.2.2017, z. A. L. , i cili rezultoi se ka marrë dublikatë të policës si pronar në datën 17.2.2017.

48.6. Si përfundim, në vlerësim të të gjitha fakteve të rezultuara nga dokumentacioni provues, shpjegimeve të subjektit, si dhe duke u bazuar në faktin se subjekti i ka deklaruar të drejtat reale mbi automjetin e mësipërm në deklaratën e vitit 2016, si dhe atë rivlerësimin kalimtar, pa pasur detyrim t’i deklarojë sipas ligjit nr. 9049/2003, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me dyshimin për fshehje të pronësisë së kësaj pasurie.

Cash në shumat prej 350,000 lekësh dhe 1,450 euro. Zotëron 100%.

49. Burimi i krijimit: nga të ardhurat nga pagat e kursyera dhe nga kontrata e lidhur me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri (Special Service Agreement SSA) nr. ***, datë 16.5.2016. Shuma 350.000 lekë dhe 1,450 euro. Zotëron 100%.

Në lidhje me likuiditetet në formë kursimesh, gjendje cash

50. Nga verifikimi i deklaratave vjetore, ndër vite, konstatohet se subjekti deklaroi për herë të parë gjendje *cash* në DIPP/2009 dhe në disa deklarata periodike të viteve pasuese ka deklaruar kursime *cash* si vijon:

- a) Në DIPP/2009: “**300,000 lekë.** Para të kursyera nga pagat gjendje në shtëpi. **330,000 lekë** para të mbetura nga borxhi I marrë sipas përshkrimeve të bëra në këtë deklaratë nga Z. N. Sh. për të likuiduar pjesën e pashlyer nga vlera totale e shtëpisë prej 2,400 euro.”.
- b) Në DIPP/2010: “...**200,000 lekë**..Të ardhura të kursyera nga të ardhurat e përvitshme të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime (paga dhe shpërblime)....”.
- c) Në DIPP/2011: “...**300,000 lekë**..Të ardhura të kursyera nga të ardhurat e përditshme të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime (paga dhe shpërblime)....”.

⁶⁶ Informacioni i marrë nga AMF.

- d) Në DIPP/2012: “...**500,000 lekë** Të ardhura të kursyera nga të ardhura të përditshme të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime sipas ecurisë së tyre në vite....”
- e) Në DIPP/2013: “...**500,000 lekë** Të ardhura të kursyera nga të ardhura të përditshme të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime sipas ecurisë së tyre në vite...”
- f) Në DIPP/2014: “...**250,000 lekë** Të ardhura të kursyera nga të ardhura të përditshme të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime për vitin 2014....”.
- g) Në DIPP/2015: “...**300,000 lekë** Të ardhura të kursyera nga të ardhura të përditshme të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime për vitin 2015...”.
- h) Në DIPP/2016: “...**350,000 lekë** Të ardhura të kursyera nga të ardhura të përditshme të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime për vitin 2016....”.

50.1. Nga analiza e deklarimeve vjetore të subjektit mbi gjendjen *cash*, konstatohet në datën 31.12.2016, subjekti i rivlerësimit dispononte gjendje likuiditete *cash* në shumën prej 1,400,000 lekësh, por *de facto* ka deklaruar shumën 350,000 lekë. Ndërkohë, në deklaratën “Vetting”, datë 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon likuiditete *cash* në vlerën 350,000 lekë dhe 1,450 euro. Në rezultatet e hetimit, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me mospërputhjen e konstatuar midis gjendjes së likuiditeteve të rezultuar Komisionit me atë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP/2016, e cila rezultonte me një diferencë prej 1,050,000 lekë.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga OSBE

51. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të deklaramit për të ardhurat e përfituara nga OSBE, ka paraqitur kontratën e shërbimit datë 16.5.2016⁶⁷, nga administrimi i së cilës rezulton se në datën 16.5.2016 është lidhur marrëveshja midis OSBE-së dhe personit të lidhur, për kryerjen e shërbimit si eksperte ligjore për periudhën 1.7.2016 - 10.7.2016, kundrejt çmimit 1,000 euro.

51.1. Nga verifikimi i mëtejshëm nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të këtë deklaruar në DIPP/2016, të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja si eksperte pranë OSBE-së. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me pagesën e përfituar, si dhe nëse mbi të ardhurat e përfituara janë paguar detyrimet tatimore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

a. Lidhur me mënyrën e deklaramit të gjendjes cash nga ana e subjektit në deklaratat periodike vjetore

52. Subjekti ka shpjeguar se gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit gjendja në *cash* e deklaruar në çdo fundvit i është referuar kursimit të akumuluar në ditën e fundit të vitit dhe nuk ka qenë asnjëherë shtesë kursimi, por deklarim i gjendjes që ka poseduar në fund të vitit, duke përfshirë të gjitha lëvizjet e *cash*-it nga periudha dhe viti paraardhës. Kjo ka qenë edhe arsyeja e mospërputhjes në deklarime.

52.1. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në DIPP/2016 ka deklaruar kursim shumën 350,000 lekë, sepse atë shumë ka pasur kursim në banesë nga ecuria e viteve, ndërkohë që edhe në deklaratën “Vetting” ka deklaruar si pasuri gjendjen në *cash* në vlerën 350,000 lekë, sepse ishte e njëjta shumë kursimi në mbyllje të vitit 2016.

52.2. Subjekti shpjegon se kjo mënyrë deklarimi e tij ka qenë permanente, e shtrirë në kohë për të gjithë periudhën e rivlerësimit dhe se nëse do të kishte kursime të akumuluar, nuk ka pasur arsye për të mos i deklaruar, por do ta deklaronte në mënyrë kumulative për çdo vit. Fakti që nuk i ka pasur ato kursime, rrjedhimisht ka bërë që ai të mos i deklaronte

⁶⁷ Kontrata nr. *** nr. ***, datë 16.5.2016 në aneksin 4/4, dosja e ILDKPKI-së faqe *** dhe termat e referencës së datës 17.5.2016, aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

ato, duke shkruar korrektësisht në fund të çdo viti shumat e rezultuara në raport me të gjitha veprimet e vitit më të hershëm.

b. Në lidhje me ligjshmërinë e krijimit të shumës 1,450 euro, të deklaruar si të ardhura nga bashkëshortja nga të ardhurat e përfituara nga puna në OSBE, si gjendje likuiditetesh cash në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”

53. Subjekti ka deklaruar se të ardhurat në shumën 1,450 euro janë deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në DIPP/2017, pasi kjo vlerë i është dhënë me çek bankar në datën 25.1.2017, pra në periudhën objekt deklarimi i deklaratës “Vetting”.

53.1. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore të të ardhurave të përfituara nga shërbimi i OSBE-së, subjekti shpjegon se sipas nenit 16 të memorandumit të mirëkuptimit me nr. ***, datë 29.5.1997, të lidhur midis OSBE dhe qeverisë shqiptare, çdo pagesë e kryer nga OSBE është e përjashtuar nga taksat.

53.2. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës aktet e njësuara me origjinalin: (i) *terms of reference* datë 17.5.2016, lëshuar nga OSBE; (ii) *Special Service Agreement*, datë 16.5.2016 lidhur ndërmjet përfaqësuesit të prezencës së misionit të OSBE në Shqipëri dhe bashkëshortes së tij; (iii) nxjerrje llogarie mbi *OSCE Payables Invoice*, datë 18.1.2017 mbi pagesat në shumën 1,450 euro; (iv) çek personal lëshuar për “Raiffeisen Bank” në shumën 1,450 euro, datë 25.1.2017; (v) memorandum mirëkuptimi mes Republikës së Shqipërisë dhe OSBE-së.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

54. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i i rivlerësimit në lidhje me gjendjen *cash* i vlerësoi ato bindëse. Nisur nga mënyra e deklarimit vit pas viti nga subjekti i rivlerësimit vihet re konsistenca e tij në deklarimin e gjendjes *cash*. Në këtë mënyrë, nga analizimi i deklarimeve periodike vjetore dhe atë “Vetting” përputhet gjendja *cash* e deklaruar në fund të vitit 2016 me atë “Vetting” në vlerën prej 350,000 lekësh.

54.1. Trupi gjykues, në përfundim, vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë të gjendjes *cash* në deklaratat periodike, pasi bazuar në ligjin nr. 9049/2003, ka pasur detyrim të deklaronte ndryshimin e gjendjes *cash* (shtim/pakësim) të rezultuar deri në datën 31 dhjetor, por kjo pasaktësi nuk e penalizon subjektin në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, për sa provohet ligjshmëria e krijimit të tyre me të ardhura të ligjshme. Në analizën financiare të viteve 2008-2016 ka ndryshuar zëri “*ndryshim likuiditeti*”, ku *cash*-i është konsideruar si gjendje *cash* të rezultuar në datën 31 dhjetor të vitit përkatës.

54.2. Ndërsa, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit si eksperte nga OSBE, trupi gjykues vëren se subjekti ka paraqitur dokumentacion të ri provues *çek bankar* tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në datën 25.1.2017 në vlerën 1,450 euro, nga ku rezulton se subjekti në deklaratën “Vetting” të dorëzuar në datën 26.1.2017, me të drejtë e ka deklaruar si *cash* të disponuar. Pra, rezulton se përputhet gjendja prej 1,450 euro e deklaruar në deklaratën “Vetting” me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti me shpjegimet përfundimtare.

54.3. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e subjektit, subjekti ka pretenduar se pagesat e kryera nga OSBE-ja janë të përjashtuara nga detyrimet tatimore, duke paraqitur si provë aktin memorandum mirëkuptimi me nr. ***, datë 29.5.1997 të lidhur midis OSBE-së dhe qeverisë shqiptare.

54.4. Trupi gjykues e administroi këtë akt, ku vë re se në nenin 16 të kësaj marrëveshjeje është e parashikuar se: “*OSBE mund të marrë në punë personel lokal, i cili do t'i nënshtrohet ligjeve dhe rregullave lokale. Megjithatë, personeli lokal i marrë në punë*”

nga OSBE do të jetë... -i përjashtuar nga taksimet mbi rrogat dhe pagesat e kryera atyre nga OSBE”. Trupi gjykues, në vlerësimin e qëllimit të këtij neni u bazua në ligjin nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku në nenin 8 “ E ardhura e tatueshme” pika 1 a) parashikohet se:

1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme:

a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës; Përjashtohen të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për marrëdhëniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatët, ose funksionarë të ngjashëm të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilët, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, ose të pranuar nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, kanë statusin e diplomatit. Nuk i nënshtrohen përjashtimeve të këtij paragrafi individët, shqiptarë apo të huaj, të cilët nuk gëzojnë statusin e diplomatit, të njohur nga konventa apo marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qëllim.

54.4.1. Gjithashtu, bazuar në nenin 15 të marrëveshjes së shërbimit të datës 16.5.2016 të lidhur midis OSBE dhe bashkëshortes së subjektit, paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës, parashikohet se “OSBE nuk merr përsipër përgjegjësitë për detyrimet tatimore apo kontributet që mund të jenë të pagueshme nga ekspertët sipas kësaj marrëveshjeje”.

54.5. Në interpretim të këtyre parashikimeve ligjore/kontraktuale, vihet re përjashtimi nga detyrimet tatimore vetëm për kategorinë e diplomatëve që punojnë pranë organizatave ndërkombëtare, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuptim, bashkëshortja e subjektit nuk gëzon statusin e diplomates. Për rrjedhojë, pagesat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit, i nënshtrohen detyrimeve tatimore, të cilat si rregull paguhen nga përfituesi i të ardhurave. Gjithsesi, këto të ardhura, si dhe të ardhurat e tjera të përfituara nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2017 nga OSBE-ja, nuk ndikojnë në vlerësimin e subjektit, pasi këto të ardhura i takojnë vitit 2017.

Në lidhje me verifikimin e deklarimit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2017

55. Komisioni, në kuadër të hetimit të plotë dhe të gjithanshëm për kriterin e pasurisë, ka kryer verifikimin e deklarimit të pasurive, të drejtave reale dhe detyrimeve të deklaruara në vitin 2017 nga subjekti dhe personi i lidhur, si dhe ka kryer një analizë paraprake të treguesve financiarë për këtë vit, ku subjekti rezultoi me pamundësi financiare në shumën - 897,838 lekë. Megjithëse subjekti paraqiti shpjegime dhe prova mbi këtë konstatim, nga Komisioni nuk u ngarkua me barrën e provës, në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa nuk u konstatuan indicie të tjera për hetime të mëtejshme përgjatë vitit 2017.

Analiza financiare për vitet 2008 – 2016

56. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit, deklaratat e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, si dhe përgjigjet e pyetësorëve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni përgatiti analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, për çdo vit, për periudhën 2008-2016.

56.1. Në përfundim të analizës financiare, para zhvillimit të seancës rezultoi se vitet 2009, 2014 dhe 2016, paraqiten me balanca negative përkatësisht, viti 2009 në shumën (-1,596,291 lekë); viti 2014 në shumën (-1,981,346 lekë) dhe viti 2016 në shumën (-696,478 lekë), pra në këto vite ka qenë në pamundësi për të përballuar pagesën e kësteve të apartamentit në Tiranë në vitin 2009 dhe 2014, të automjetit në vitin 2016, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të rezultuara gjatë hetimit administrativ. Subjektit të

rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

57. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet për analizën financiare ka përsëritur kundërshtimet e tij të paraqitura në seksionin e vlerësimit të pasurisë apartament që lidhen me pagesën e këstit të parë prej 30,000 euro në vitin 2009, të këstit të tretë prej 13,500 euro në vitin 2014, si dhe ato të paraqitura në lidhje me gjendjen e *cash*-it për vitin 2016. Gjithashtu, në analizën e vitit 2016, subjekti ka kundërshtuar edhe përlogaritjen e shpenzimeve jetike, duke shpjeguar se shpenzimet në këtë vit duhet të konsiderohen në masën 50% më të ulta, pasi në muajin prill të këtij viti ka lindur djali i tij, ndërsa fëmija tjetër ka qenë i mitur dhe për rrjedhojë shpenzimet nuk mund të konsiderohen nga Komisioni, në të njëjtën masë sikurse shpenzimet për një person të rritur.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

58. Trupi gjykues, vlerëson se pretendimet në lidhje me çështjet e kundërshtuara nga subjekti në këtë analizë, janë trajtuar gjerësisht në seksionet përkatëse, të cilat janë pranuar, përveç pretendimit për uljen e shpenzimeve jetike, çështje e cila tashmë përbën një praktikë të konsoliduar në procesin e rivlerësimit ndaj subjekteve të rivlerësimit (vendim 8/2021 (JR), datë 9.3.2021⁶⁸).

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të pasurisë

59. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, deklaratat e subjektit në deklaratat e pasurive dhe në përgjigjet e pyetsorëve, shpjegimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës, provat e paraqitura nga ai, si dhe bazuar në parimin proporcionalitetit vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me mundësitë financiare për të përballuar krijimin e pasurive, kryerjen e shpenzimeve, në lidhje me burimet e personave të tjerë të lidhur, si dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre. Nga kontrolli i pasurive, nuk u konstatuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Subjekti nuk ka kryer deklaram të rremë dhe nuk është gjendur në situatë konflikti interesi. Trupi gjykues vlerëson se nga analizimi i pasurive të subjektit janë konstatuar disa pasaktësi në deklaram, në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, por këto pasaktësi të konstatuara nuk e bëjnë të pamjaftueshëm deklaramin, në kuptim të nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa provohet burimi i ligjshëm i krijimit të pasurive. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

60. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Shehaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ai ka apo ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

60.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 i ka dërguar Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 2.11.2017 me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

⁶⁸ Shpenzimet bazike që përlogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtushme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore.

60.2. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar⁶⁹ DSIK-së përditësimin e raportit me informacione të tjera të mundshme. Në raportin e përditësuar⁷⁰ me informacione të ardhura nga autoritetet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, konkludohet se: *“Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Erjon Shehaj, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.”*

Hetimi i kryer nga Komisioni në kuadër të kontrollit të figurës

61. Komisioni ka kryer një hetim⁷¹ të pavarur, duke kërkuar informacion pranë organeve kompetente në lidhje me figurën, në kuptim të nenit 38 të ligjit 84/2016, ku nga hetimi nuk rezultuan indicie në lidhje me kontakte të papërshtatshme të subjektit me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

61.1. Në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga autoritetet verifikuese, Komisioni ka administruar disa dosje hetimore të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat pas shqyrtimit dhe analizimit të tyre, u konsideruan të lidhura me kriterin profesional dhe janë paraqitur të integruara në seksionin e kriterit profesional, referuar si *“Gjetje të tjera”*.

61.2. Për rrjedhojë, Komisioni i komunikoi subjektit se konkluzionet e raportit të kontrollit të figurës do të vlerësohen edhe në raport me çështjet profesionale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

62. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar procedurën e ndjekur nga grupi i punës të DSIK-së, duke pretenduar se është i paplotë, pasi nuk ka zbatuar rregullat e ndjekura për kryerjen e vlerësimit, sipas nenit 38 pika 3, e ligjit nr. 84/2016, për sa në informacionin e përcjellë Komisionit nuk jepet asnjë e dhënë, provë apo rrethanë ku mbështetet ky informacion për dyshime mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës.

62.1. Subjekti i rivlerësimit është dakord me qëndrimin e konfirmimit fillestar të DSIK-së, sipas të cilit konfirmohet se: ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi dhe se nuk ka informacion në deklaramin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Në këtë kuptim i ka kërkuar Komisionit ta konsiderojë këtë raport dhe ta konstatojë të përshtatshëm në kuadër të kontrollit të figurës.

62.2. Në lidhje me vlerësimin e Komisionit dhe procedurën e ndjekur në kuadër të kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit është shprehur se kontrolli i figurës është i bazuar në standarde të tjera kontrolli, të ndryshme nga kriteri profesional, prandaj dhe në këtë kuptim ka kërkuar që gjetjet e disa dosjeve profesionale të vlerësohen në kuadër të kriterit profesional, në mbështetje edhe të tagrave që i jepen Komisionit për të shtrirë hetimin nga 1 janari 2006 e në vazhdim, bazuar në nenin 41/4 të ligjit nr. 84/2016.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

63. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, vlerëson se bazuar në nenin 36 pika 1 e ligjit nr. 84/2016 institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.10.2021.

⁷⁰ Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 20.12.2021, të KDZH-së.

⁷¹ Përmendim këtu ndër të tjera hetimin e kryer në prokuroritë e rretheve dhe Prokurorinë e Posaçme.

Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. DSIK-ja është institucion i krijuar me ligjin nr. 8457/1999, “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, i cili në objektin e veprimtarisë funksionon mbi bazën e disa standardeve ligjore. Gjithashtu, nga ana tjetër edhe ligji nr. 84/2016, në nenin 38 të tij ka përcaktuar standarde kontrolli për t’u respektuar nga struktura përgjegjëse gjatë procesit të kontrollit të figurës ndaj subjekteve të rivlerësimit, të cilat duket se janë respektuar nga DSIK-ja dhe strukturat mbështetëse të saj.

63.1. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit në lidhje me paplotësinë e procedurës së ndjekur nga grupi i punës i caktuar për kontrollin e figurës, për sa subjekti nuk e bazoi pretendimin në ndonjë shkak ligjor që të mund ta bënte të cenueshme procedurën e ndjekur nga grupi i punës. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë pretendim, arsyeton se konkluzioni nuk është bazuar në prova apo në ndonjë të dhënë konkrete.

63.2. Trupi gjykues, gjen me vend të theksojë se procedura e punës së ndjekur nga strukturat përgjegjëse për kontrollin e figurës bazohet në standarde të përcaktuara shprehimisht në nenin 38 të ligjit 84/2016, por dhe në kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 8457/1999 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij gjatë trajtimit të informacionit nëse rrezikohet siguria e burimit. Në këtë kuptim, informacioni i klasifikuar me rezervë në rastin konkret nuk ka cenuar të drejtat e subjektit për t’u njohur me raportin e përgatitur nga grupi i punës, të deklasifikuar pjesërisht dhe as të drejtën e mbrojtjes në respektim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

63.3. Në vijim, trupi gjykues, vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit se kontrolli i figurës bazohet në standarde të tjera të ndryshme nga kriteri profesional, ndaj dhe në këtë kuptim, gjetjet profesionale duhet të trajtohen ngushtësisht në kuptim të kriterit profesional, për sa nga hetimi nuk u provuan kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të kreut V të ligjit nr. 84/2016, që rregullon kontrollin e figurës. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion bazuar dhe në orientimin⁷² e dhënë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, sipas vendimit (JR) nr. 20, datë 8.9.2020.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

64. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Shehaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

65. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional në procesin e rivlerësimit kalimtar, ka përgatitur dhe dërguar në Komision një raport të detajuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e këtyre burimeve: 1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; 2) pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; 3) të dhënat nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë; 4) të dhënat nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Sektori i Protokoll-Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme.

⁷² Shih pg. 34.4 të vendimit JR nr. 20, datë 8.9.2020.

65.1. Në raport janë analizuar dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit⁷³, si dhe dosjet e shortuara⁷⁴ mbi bazën e kriterëve të vlerësimit përcaktuar në ligjin nr. 96/2016: a) aftësitë profesionale; b) aftësitë organizative; c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

65.2. Gjithashtu, për vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, KLP -ja u është referuar edhe të dhënave arkivore lidhur me ankesat të regjistruara për subjektin/kallëzimet e depozituara, si dhe vlerësimet e dhëna ndaj tij, të cilat i ka trajtuar, por nuk ka gjetur indicie/gjetje, si dhe nuk ka rezultuar të ketë masa disiplinore ndaj prokurorit Erjon Shehaj.

65.3. Në përfundim, grupi i punës ka konkluduar raportin bazuar në kriteret e rivlerësimit si vijon:

- a) **në lidhje me aftësitë profesionale:** prokurori shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Referuar akteve të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se kryen analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.
- b) **në lidhje me aftësitë organizative:** nga analizimi i 5 dosjeve të shortuara, për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Erjon Shehaj ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuar dhe numrit total në çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit, duke specifikuar se për periudhën e vlerësimit ka qenë pjesë e Njësisë së Përbashkët Hetimore kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, procedime penale që nga natyra e tyre kërkojnë një kohë të gjatë për zgjidhjen e tyre.
- c) **në lidhje me etikën dhe vlerat profesionale:** përdor një gjuhë që është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Erjon Shehaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.
- d) **në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimi profesional:** komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Prokurori ka treguar kujdes të veçantë për bashkëpunimin me institucionet e tjera të cilat janë të angazhuar me ndjekjen penale. Gjithashtu rezulton se subjekti gjatë kohës së rivlerësimit dhe më parë ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

⁷³ 1) *Konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. *** të vitit 2014 në ngarkim të të pandehurve L. G., A. Sh., Z.J., G. G., G.N., Z. Gj., E. G., A. T., D.Z., V. K.i, V. D. Gj. P., P. L., Ll.P., Gj. S., M. P.*; 2) *Ankim për vendimin e Gjykatës për procedimin penal nr. *** me të pandehur M.P të akuzuar për kryerjen e veprave penale të "Vrasjes me dashje" dhe "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit" të kryer dy herë, të parashikuar nga nenet 76, 278/2 dhe 278/2 të Kodit Penal, dhe në ngarkim të shtetasve A. T., È.(E.) N.dhe S.(M.) P.të akuzuar respektivisht për kryerjen e veprës penale të "Moskallëzimit të krimit" të parashikuar nga neni 300 të Kodit Penal. Akt i datës 19.09.2016; 3) *Kërkesë për gjykim të drejtpërdrejtë të çështjes penale nr.***.**

⁷⁴ Dosja nr. ***. "Vendim për mosfillimin e kallëzimit penal nr. *** datë 29.7.2016"; dosja nr. ***. "Vendim për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, datë 16.01.2015"; dosja nr. ***. "Vendim për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, datë 22.10.2014"; dosja nr. ***. "Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, datë 26.12.2014"; dosja nr. ***. "Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, datë 4.3.2014".

66. Komisioni ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit mbi bazën e dokumenteve të paraqitura nga subjekti, dosjeve profesionale të shortuara, informacionit të disponuar në dosjen e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me etikën dhe integritetin e tij, indicieve të ardhura nga autoritetet verifikuese, si dhe denoncimet e publikut, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nenet 40 e vijues të ligjit nr. 84/2016, nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

66.1. Nga analizimi i akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjeve të shortuara, u evidentuan gjetjet e mëposhtme:

a. Procedimi penal nr. ***

67. Në lidhje me këtë dosje evidentohen këto fakte: në datën 16.6.2014, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”, parashikuar në nenin 237 të Kodit Penal, mbi bazën e materialit të referuar nga Komisariati i Policisë Lezhë, me personin në hetim shtetasin N. Ll.

67.1. Me vendimin e datës 16.9.2014, “Për zgjatjen e afatit hetimor në procedimin penal ***/2014”, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve nga data 16.9.2014 - 31.12.2014, për të kryer disa veprime hetimore si marrja në pyetje e shtetasit A. T., si person që ka dijani për veprën penale.

67.2. Në vijim, në datën 16.12.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor në procedimin penal nr. *** nga data 16.12.2014-16.3.2015 për kryerjen e disa veprimeve hetimore, të cilat për shkaqe objektive kanë mbetur pa u kryer, si pyetja e personave të pranishëm, administrimi i pamjeve filmike në vendin e ngjarjes, si dhe veprime të tjera që lindin të nevojshme gjatë hetimit.

67.3. Me vendimin e datës 16.1.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal bazuar në nenin 328/1 germa “b” të Kodit të Procedurës Penale për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Vihet re se ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim, referuar informacionit të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 5.11.2021 nga Prokuroria Lezhë, dokument në dosjen e ardhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

67.4. Nga administrimi i dosjes së hetimit, nuk u vërejt kryerja e ndonjë veprimi procedural tjetër nga subjekti i rivlerësimit pas datës 17.11.2014, për të justifikuar vendimin e marrë për zgjatjen e afateve të hetimeve nga data 16.12.2014 - 16.3.2015. Gjithashtu, vendimi për zgjatjen e afatit hetimor të datës 16.12.2014 konstatohet se nuk i është njoftuar personit nën hetim. Nga analizimi i fakteve rezulton se kallëzuesi ka kallëzuar shtetasin N.Ll., për shkak se i ka dalë përpara atij, duke ia zënë rrugën dhe jo vetëm e ka goditur por edhe e ka kërcënuar dhe fyer kallëzuesin si punonjës policie⁷⁵, për shkak se e kishte ndaluar një natë me parë gjatë ushtrimit të detyrës si oficer patrulle pranë Komisarariatit të Policisë Lezhë. Fakte⁷⁶ të ngjashme dalin edhe nga deklaratimet e shtetasve që kanë dijani për çështjen penale, si më sipër.

⁷⁵ Shih faqen e dytë të procesverbalit për kallëzimin e veprës penale të datës 11.06.2014, ku kallëzuesi citon ndër të tjera se shtetasi N. Ll., më tha: “Përse më ke ndaluar mbremë, po më dole më para për kontroll, do të më njohësh se kush jam unë, unë kam bërë burg e nuk kam frikë prej burgut, unë të zhdok, të vras, të ..., familjen”. ...më tërhoqi rrëmbimthi syzet e diellit të cilat i kisha të varura te bluza dhe vazhdoi të më shante me zë të lartë nga familja, nëna, nga motra.”

⁷⁶ Të nesërmen unë kam qenë në ditën time të pushimit dhe nuk e kam takuar kolegun tim M.N., por ai më ka telefonuar dhe më ka treguar që njëri nga personat që ne kishim kontrolluar më parë, e kishte takuar në rrugë dhe e kishte kërcënuar për arsyen pse i kishte kontrolluar dje, duke i thënë që mbremë më keni kontrolluar kot dhe cila ka qenë aryeja e kontrollit dhe ishin konfrontuar edhe fizikisht.

67.5. Nga analizimi i fakteve të kallëzuara nga shtetasit që kanë dijeni për veprën penale është konstatuar se, verifikohen rrethana që kallzuesi është ndier i kërcënuar për shkak të ushtrimit të detyrës si oficer policie, por subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit N. Ll. vetëm për veprën penale “Goditje për shkak detyre” dhe jo për “Kanosje për shkak të detyrës”, parashikuar në nenin 238 të Kodit Penal.

67.6. Nga ana tjetër, nga analizimi i vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, nuk duket që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë një analizë të veprimeve procedurale dhe fakteve të rezultuara nga hetimi për të dalë në një konkluzion të bazuar në drejtim të përcaktimit të përgjegjësisë penale.

67.7. Gjithashtu, subjekti nuk ka arsyetuar në lidhje me vendimin për pushimin e procedimit, të lidhur me shkakun se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se në rastin konkret nuk ndodhemi përpara veprës penale të “Goditjes për shkak të detyrës”⁷⁷, pa analizuar faktet se përse veprimet e shtetasit Ll. ndaj kallzuesit, shtetasit M. N., nuk përbëjnë vepër penale. Duket se vendimin e ka bazuar vetëm në deklaratimet e shtetasve që kanë dijeni për veprën penale, pa vlerësuar faktet që dalin nga deklaratimet e tyre, në raport me faktet e deklaruara nga vetë kallzuesi dhe pa kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme si administrimi i kamerave të sigurisë në momentin e ndodhjes së ngjarjes, për kryerjen e të cilit subjekti kishte shtyrë afatin e hetimeve me vendimin e datës 16.12.2014.

67.8. Në vlerësimin e këtij procedimi, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka konsideruar faktin se personi nën hetim, shtetasi N. Ll., ishte person në kërkim për shkak se ishte i dyshuar për kryerjen e disa veprave penale, referuar raportit *TIMS* të administruar nga dosja e hetimit.

67.9. Nga analizimi i fakteve të paraqitura në kallëzim në raport me faktet e paraqitura në vijim në procesverbalin e datës 4.7.2014, nga kallzuesi, duket se kallzuesi ka ndryshuar pjesërisht deklarin e tij, duke kërkuar në fund të mos ndiqet penalisht shtetasi N. Ll. dhe subjekti i rivlerësimit nuk e ka hetuar këtë fakt në lidhje me ndryshimin e deklarin. Madje vërehet se procesverbalin e datës 4.7.2014 është nënshkruar në dy versione⁷⁸ nga kallzuesi, ku në njërin version kallzuesi deklaroi se e ka sqaruar konfliktin dhe kërkon të mos ndiqet penalisht, ndërsa në versionin tjetër të procesverbalit të së njëjtës date, nuk i deklaroi këto rrethana.

67.10. Nga administrimi i dosjes së hetimit vihet re se me aktin e kontrollit të datës 30.12.2014, zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë nuk ka qenë dakord me vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit për pushimin e këtij procedimi, duke paraqitur edhe arsytet, ndërsa në datën 19.2.2015 ka lëshuar një raport përfundimtar mbi kontrollin e ushtruar në dosjen penale, në të cilin konkludon: *“Nuk jam dakord me vendimin. Në lidhje me këtë çështje është ushtruar kontrolli me dt. 30.12.2014 ku janë parashtruar arsyet e mosqenies dakord me vendimin e pushimit. Nuk rezultoi të jetë kryer asnjë veprim hetimor procedural pas datës së kontrollit. Gjithashtu e përsërisim që duhet sqaruar momenti që lidhet me kryerjen e veprimeve nga personi nën hetim ndaj punonjësit të policisë, i cili që në momentet e para në kallëzim dhe deklarin e dhënë pranë të jetë goditur nga shtetasi N.Ll., më pas para of.pol.gjyq të Prokurorisë nuk e prezantoi këtë fakt. Duhet marrë në konsideratë ky moment pasi pikërisht mbi bazën e kallzimit dhe deklarin të punonjësit të policisë është marrë në përgjegjësi penale*

⁷⁷ Shih arsyetimin e subjektit në faqen 3 të vendimit për pushimin e procedimit penal të datës 16.01.2015.

⁷⁸ Shih procesverbalin e datës 4.7.2014 paragrafin e fundit në përgjigje të pyetjes “Keni gjë tjetër për të deklaruar?”.

shtetasi N. Ll., person ky i dhunshëm dhe problematik. Gjithashtu të verifikohen të dhënat përkatëse tek salla operative.”

67.11. Mbi bazën e gjetjeve të konstatuara në dosjen e mësipërme, trupi gjykues i kaloi subjektit të drejtën për të paraqitur shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

68. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në lidhje me vendimin e datës 16.9.2014 për shtyrjen e hetimeve, i cili është bërë me qëllim: i) marrjen në pyetje të shtetasit A. T., të cilit i janë marrë dy deklaramë; ii) pyetjen e personave të tjerë të pranishëm, si edhe administrimi i pamjeve filmike të mundshme për ngjarjen. Në kushtet kur nuk është bërë e mundur pyetja e personave, ka çmuar shtyrjen e hetimeve edhe për një periudhë tjetër. Subjekti ka shpjeguar se vendi ku ka ndodhur konflikti nuk ka pasur mbulim me kamera, si dhe nuk është bërë e mundur marrja e deklaramit nga personat e pranishëm të ndodhur në vendngjarje.

68.1. Subjekti ka shpjeguar se megjithëse shtyrja e dytë e hetimeve nuk rezultoi me përfitim e ndonjë të dhënë apo prove tjetër për hetimin e zhvilluar, nga ana tjetër është detyrim i prokurorit që të bëjë të gjitha përpjekjet sipas mjeteve të kërkimit të provës të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, të mbledhë dhe administrojë akte të cilat hedhin dritë në drejtim të hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të rastit.

68.2. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me mosnjofitim e të pandehurit për shtyrjen e afatit të hetimeve, shpjegon se njoftimi nuk rezultoi në nënshkruar nominalisht nga i pandehuri, por për shkak të periudhës së shkuar, pasi është njohur edhe me dosjen penale të vitit 2014, ka deklaruar se ka deleguar kryerjen e veprimit tek policia gjyqësore, por nuk është bërë e mundur njoftimi i të pandehurit, me vendimin e shtyrjes së afatit të hetimit, për shkak të mosgjethjes së tij nga ky i fundit. Një rrethanë e tillë nuk përbën mohim të së drejtës për t'u ankuar në gjykatë ndaj këtij vendimi, për shkak se në bazë të nenit 325 të K.Pr.Penale, i pandehuri ka të drejtën e ankimit në gjykatë, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit. Në përputhje me këtë përcaktim ligjor, e drejta e të pandehurit për t'u ankuar në lidhje me vendimin për shtyrjen e hetimeve, jo vetëm që nuk është e kushtëzuar nga njoftimi formal i vendimit, por nga ana tjetër si person i legjitimuar për t'u njoftuar me statusin e hetimit, në çdo moment nëse do shfaqte interes i pandehuri, detyrimisht do të njihej me fazën e hetimit, duke i lindur rrjedhimisht e drejta për t'u ankuar ndaj afateve të hetimit në gjykatë.

68.3. Në lidhje me faktin se ka pasur rrethana të kanosjes së kallëzuesit, të cilat nuk janë verifikuar nga subjekti, ai ka shpjeguar se nga administrimi i gjithë deklaramëve në funksion të këtij procedimi nuk ka dalë asnjë e dhënë tjetër, e cila të hidhte dritë apo të provonte kanosjen apo goditjen e personit punonjës të Policisë së Shtetit. Deklarimi i bërë nga ana e shtetasit Gj.D., i cili ishte koleg i kallëzuesit, i referohet vetëm faktit të tregimit të ngjarjes që i ishte bërë atij nga kallëzuesi, pra si një deklaram i derivuar nga kallëzuesi, dhe jo tregim rrethanash në vendin e ngjarjes dhe deklarami nuk referon në të dhëna të mjaftueshme në drejtim të provueshmërisë së kryerjes së veprës penale. Në përfundim, subjekti ka shpjeguar se vetëm deklarami fillestar i kallëzuesit para oficerit të policisë gjyqësore ishte çmuar i pamjaftueshëm për të ngritur dhe mbrojtur akuzën para gjykatës, ndërsa theksoi se ndaj vendimit të pushimit nuk rezultoi të jetë ushtruar ankim nga palët.

68.4. Për sa i përket moskryerjes së hetimit në lidhje me rrezikshmërinë e të pandehurit, subjekti ka shpjeguar se në referim të printimit të të dhënave nga sistemi, rezultoi se për vitin 2013, Drejtoria e Policisë referonte fillimisht shpalljen e shtetasit N.Ll. në kërkim (në datën 21.11.2013, e më pas në datën 30.12.2013, e ka anuluar këtë shpallje, për shkak kalim afati). Pas këtij momenti nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër, pasi domosdoshmërisht, prej shërbimeve të Policisë Gjyqësore në momentin e paraqitjes së tij

në Prokurori për t'u pyetur, do të bëhej referimi përkatës për shoqërimin e nevojshëm, edhe në funksion të objektit për të cilën ishte bërë kjo shpallje më e hershme.

68.5. Në lidhje me vërejtjet e konstatuara në dosjen e hetimit, subjekti ka shpjeguar se në përputhje me rregullat e kontrollit të vendimmarrjes në prokurori, vendimi i pushimit dhe në tërësi fashikulli i hetimit paraparak i kalonte për hierarki zëvendësdrjtuesit e më pas drjtuesit të Prokurorisë. Duke qenë i bindur në vendimmarrjen përpos mendimit të zëvendësdrjtuesit të Prokurorisë, procedimi është përcjellë tek drjtuesi i Prokurorisë, i cili përmes konfirmimit të dosjes penale me nënshkrimin e tij, ka vendosur arkivimin më 22.2.2015.

68.6. Subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se në lidhje me këtë procedim ka zhvilluar një hetim në përputhje me afatet dhe përcaktimet e K.Pr.Penale, ka marrë një vendim në çmuarjen objektive të rrethanave të faktit dhe mbi bindjen e brendshme të krijuar nga vlerësimi në unitet i të dhënave të përfutuara nga ky hetim.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

69. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga administrimi i akteve në dosjen hetimore në lidhje me veprimet hetimore të kryera nga subjekti konstatohet se nuk qëndron shpjegimi i subjektit për shtyrjen e afatit të hetimeve për pyetjen e personave të tjerë, pasi marrja në pyetje e personave, të cilët mund të tregonin rrethana të ngjarjes, ishte kryer brenda datës 17.11.2014. Gjithashtu, edhe administrimi i kamerave, veprim për të cilin ishte shtyrë hetimi, nuk ishte kryer dhe se subjekti nuk ka arsyetuar pamundësinë objektive për marrjen e kamerave, sikurse pretendon në prapësime. Pra, nga analizimi i veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit u konstatua se vendimi i shtyrjes së afatit të hetimeve për periudhën 16.12.2014-16.3.2015 rezultoi i panevojshëm, për sa nuk u konstatua kryerja e ndonjë veprimi hetimor që të mund të justifikonte shtyrjen e hetimeve.

69.1. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provonte se e kishte kryer njoftimin ndaj personit nën hetim në lidhje me vendimin për zgjatje afati të datës 16.12.2014, sikurse kishte vendosur. Pretendimi i subjektit se të pandehurit nuk i janë mohuar të drejtat, për arsye se ai ka pasur mundësi të interesohej për fazat e hetimit gjatë procesit të hetimit e për rrjedhë të mund të ushtronte të drejtat e ankimit, është i pabazuar në ligj. Gjithashtu, po i pabazuar në ligj vlerësohet edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me përpjekjet për delegimin e përgjegjësive të tij oficerit të Policisë Gjyqësore për kryerjen e njoftimit ndaj të shtetasit N. Ll., për sa në dosjen e hetimit nuk u vërejt ndonjë aktdelegimi. Trupi gjykues gjen me vend të theksojë se funksionet e Policisë Gjyqësore janë të përcaktuara në ligj dhe se bazuar në nenin 30 të Kodit të Procedurës Penale, policia gjyqësore kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose deleguar nga prokurori.

69.2. Për sa i përket çështjes së rrezikshmërisë së të pandehurit dhe moskryerjes së veprimeve të duhura hetimore nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, pasi dëgjoi pretendimin e subjektit se shpallja si person në kërkim të të pandehurit është anuluar në datën 30.12.2013, për shkak kalim afati dhe pas këtij momenti nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër, si dhe pasi u konsultua me dosjen e hetimit, nuk e gjeti të bazuar këtë pretendim. Në dosjen e hetimit konstatohet raporti i *TIMS* i datës 11.6.2014 që e referon shtetasin N.Ll, si person me probleme dhe i shpallur në kërkim, të cilit i është refuzuar edhe hyrja në shtetin italian, pasi përbën rrezik kombëtar. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e plota hetimore për të vlerësuar rrezikshmërinë e këtij shtetasi të marrë si person nën hetim. Ky konkluzion vjen në harmoni edhe me përfundimet e kontrollit të dosjes të lëshuara në datën 19.2.2015 nga

zëvendës drejtuesi i Prokurorisë, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

69.3. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se kishte hetuar në lidhje me faktet e referuara në kallëzim nga oficeri i Policisë Gjyqësore, shtetasi M.N. për sa ai ndihej i kërcënuar nga i kallëzuar, shtetasi N.Ll. dhe as në lidhje me ndryshimin e deklaramit të kallëzuesit për sa i përket kërkesës së tij mbi mosndjekjen penalisht të të kallëzuarit. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se kishte kryer të gjitha veprimet hetimore në lidhje me vlerësimin e përgjegjësive penale ndaj shtetasit N. Ll., që të justifikonte vendimin për pushimin e procedimit ndaj tij për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”.

69.4. Vendimi për pushimin e procedimit duket se është bazuar vetëm në deklaramit e shtetasve që kanë dijeni për veprën penale, pasi këto deklaramit janë të vetmet prova të evidentuara në dosjen hetimore, që gjejnë pasqyrim edhe në arsyetimin e vendimit nga subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që nuk rezultoi kryerja e ndonjë veprimi hetimor për zbardhjen e së vërtetës në lidhje me veprimet e të kallëzuarit ndaj kallëzuesit, sikurse administrimi i kamerave të sigurisë në vendin e ngjarjes ku kallëzuesi ishte goditur.

69.5. Në analizë të këtyre fakteve, trupi gjykues vlerëson se veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë të pamjaftueshme për të konkluduar në pushimin e procedimit penal. Por, në kuptim të kriterit profesional gjetjet e konstatuara në këtë dosje penale nuk e penalizojnë subjektin, sipas nenit 61 pika 4 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në parimin e proporcionalitetit, por përbëjnë shkak për referim pranë organit kompetent për inspektimin e mëtejshëm në kuadër të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

b. Procedimi penal nr. ***

70. Në lidhje me këtë dosje kanë rezultuar këto fakte: me urdhrin e datës 21.9.2014, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal me të pandehur shtetasin G. L., mbi bazën e materialit referues të Komisarariatit të Policisë Lezhë nr. *** prot., datë 21.9.2014, ku është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore, me qëllim përcaktimin e faktit penal, si dhe për sqarimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale. Nga akti i ekspertimit mjekoligjor në datën 22.9.2014, është konkluduar si vijon: “*dëmtimet e shkaktuara shtetasit Gj.N. futen në kategorinë e atyre që kanë sjellë humbjen e aftësisë për punë deri në 9 ditë*”.

70.1. Në datën 20.9.2014 është kryer arresti në flagrancë i të pandehurit, si dhe është bërë kontrolli personal i tij, ku në vijim në datën 22.9.2014 është kërkuar vleftësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit nga subjekti i rivlerësimit.

70.2. Me vendimin nr. ***, datë 24.9.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur: pranimin e kërkesës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, duke vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë, të vendosur nga Policia Gjyqësore Lezhë ndaj të dyshuarit G. L.. Caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore ditën e hënë të javës së katërt të çdo muaji nga ora 11.00 -14.00, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale”. Urdhërohet lirimi i të arrestuarit nga gjendja e paraburgimit.

70.3. Me vendimin “Për pushimin e procedimit penal nr. ***”, datë 22.10.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “f”, pasi vepra penale ndiqet me ankim para gjykatës nga i dëmtuari, bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim, referuar informacionit të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë

5.11.2021 nga Prokuroria Lezhë, dokument në dosjen e ardhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

70.4. Nga analiza e fakteve dhe akteve pjesë e dosjes së hetimit, si dhe të vendimit për pushimin e procedimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit, vihet re se subjekti i rivlerësimit në vendimin e marrë i është referuar aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 22.09.2014, sipas të cilit dëmtimet e shkaktuara viktimës kategorizohen tek dëmtimet që sjellin humbjen e aftësisë për punë deri në 9 ditë, e për rrjedhojë e ka pushuar procedimin pasi, sipas nenit 59 të Kodit Procedurës Penale, i dëmtuari mund të kërkojë ndjekjen penale drejtpërdrejt në Gjykatë, për të marrë pjesë si palë dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

70.5. Vihet re se në arritjen e këtij konkluzioni, subjekti referon veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar në nenin 89 të Kodit Penal, dispozitë e cila parashikon rastet kur nga dëmtimi është shkaktuar paaftësi e përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, ndërkohë dëmtimet të cilat sjellin paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, siç është konkluduar në rastin konkret nga ekspertiza mjekoligjore, parashikohen nga neni 90 i Kodit Penal “Dëmtime të tjera me dashje”, të cilat ndiqen me kërkesë në gjykatë nga i dëmtuari, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale.

70.6. Komisioni, pasi analizoi këtë dosje, evidentoi se subjekti nuk kishte bërë cilësimin juridik të duhur të veprës penale, mbi bazën e së cilës kishte vendosur pushimin e procedimit me shkakun se vepra penale ndiqet me ankim të të dëmtuarit.

70.7. Gjithashtu, në arsyetimin e vendimit, subjekti i rivlerësimit i është referuar edhe një tjetër akti ekspertimi teknik, me nr. ***, datë 11.7.2014,⁷⁹ i cili referuar datës së lëshimit dhe veprës penale të cilës i referohet “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal, duket se i përket një procedimi tjetër në ngarkim të shtetasit G. L.⁸⁰ . Mbi bazën e këtyre gjetjeve, Komisioni i kaloi subjektit të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

71. Subjekti ka shpjeguar se, në lidhje me këtë procedim janë kryer një tërësi veprimesh hetimore, në përfundim të të cilave është identifikuar autori i dyshuar, duke u caktuar edhe masa përkatëse e sigurimit, deri në përfundimin e hetimit. Duke qenë se nga ana objektive pasojat e veprës penale të dyshuar kishin sjellë një paaftësi tek i dëmtuari në masën deri në 9 ditë, dhe jo mbi 9 ditë, sikurse kërkonte neni 89 i Kodit Penal, atëherë është çmuar dhe konkluduar se në rastin konkret procedimi i filluar për veprën penale të “Plagosja e lehtë me dashje” duhet të pushojë, pasi dëmtimi i sjellë tek i dëmtuari përbën figurën e një vepre tjetër penale, për të cilën ndjekja penale ushtrohet drejtpërdrejt në gjykatë sipas nenit 59 të K.Pr.Penale.

71.1. Subjekti ka pranuar se cilësimi juridik për veprën penale për të cilën ka pushuar procedimin penal nuk është cituar shprehimisht prej tij në vendimin e pushimit, por ka rezultuar e qartë që ndodhej para veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”, për të cilin prokuroria nuk ka kompetencë për të vijuar hetimin e nisur, prandaj edhe është proceduar me pushimin e çështjes.

71.2. Në lidhje me referimin tek një tjetër akteksptimi, subjekti ka shpjeguar se në lidhje me aktin e ekspertimit teknik të sendit të dyshuar *shkop bejzbolli*, pas regjistrimit të procedimit penal, nga deklarimet e administruara ka rezultuar se i dëmtuari është goditur me një send të fortë të dyshuar *shkop bejzbolli*, ndërkohë që i proceduari ka deklaruar se

⁷⁹ Sipas të cilit citon se me akteksptimin teknik me nr. ***, datë 11.7.2014, është konkluduar se materiali objekt ekspertimi shkop gome, me përmasa 90 cm, nuk futet në kategorinë e armëve të ftohta.

⁸⁰ I cili referuar gjeneraliteteve duket se është i pandehuri në procedimin nr. ***.

nuk ka pasur armë të ftohtë me vete, por sulmin e ka kryer me një shkop që ka konstatuar jashtë ambientit ku ka kryer sulmin. Për verifikimin e plotë të ngjarjes, në Prokurori janë kryer verifikime edhe mbi procedime të tjera me të hetuar personat e kallëzuar, prej ku ka rezultuar se i hetuari G. L. ka qenë i proceduar edhe më parë. Nga hetimi më i hershëm janë këqyruar aktet e administruara në kuadër të atij procedimi, ku me interes është çmuar sendi i dyshuar, i cili mund të ketë shërbyer edhe për sulmin ndaj Gj.N., duke qenë se ky send i ngjashëm është sekuestruar edhe më herët në automjetin e të pandehurit. Sikurse rezultoi edhe nga akti i ekspertimit teknik, ky send nuk përmbushte kriteret për t'u klasifikuar armë e ftohtë.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

72. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit në tërësi në lidhje me këtë procedim, i vlerësoi ato bindëse. Subjekti në shpjegimet e tij ka pranuar vetë se nuk ka kryer saktësisht cilësimin juridik të veprës penale në vendimin e pushimit të procedimit, por trupi gjykues vlerëson se kjo pasaktësi nuk e penalizon subjektin, pasi shkak për të cilin ka pushuar procedimin dhe baza ligjore e përdorur ka qenë e saktë. Gjithashtu, në lidhje me përdorimin e një tjetër aktekspertimi teknik në dosjen e procedimit, atë me nr. ***, datë 11.7.2014, trupi gjykues, pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore të datës 29.3.2022, i cili shpjegoi nevojën e administrimit të këtij akti në kuadër të hetimit të plotë, i vlerësoi ato bindëse.

Në lidhje me ankesat/kallzimet të regjistruara ndaj subjektit të rivlerësimit

a. Ankesa M. dhe F. M.

73. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur, duke kërkuar çdo informacion për subjektin e rivlerësimit në lidhje me ankesa, procedime disiplinore, kallëzime/procedime penale të paraqitura ndaj tij në KLP⁸¹ Prokurinë e Përgjithshme⁸², Prokuroritë e Rretheve⁸³ dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁸⁴. Nga administrimi i informacionit dhe dokumentacionit⁸⁵ të ardhur nga këto institucione, vihet re se ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar disa kallëzime penale, të cilat janë cituar edhe në raportin e KLP-së, por nuk ka rezultuar të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të tij.

73.1. Në kuadër të hetimit të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë⁸⁶ informon se: *ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar procedimi penal me*

⁸¹ Kërkesë me nr. *** prot., datë 11.1.2021, drejtuar KLP-së dhe kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 19.01.2021.

⁸² Kërkesë me nr. *** prot., datë 11.1.2021 dhe kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.4.2021, dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme bashkë me informacionin e ardhur nga prokuroritë e rretheve.

⁸³ Kërkesë me nr. *** prot., datë 22.12.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; Kërkesë me nr. *** prot., datë 28.10.2021; dhe kërkesë me nr. *** prot. datë 22.12.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Kurbin; kërkesë me nr. *** prot., datë 22.12.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; kërkesë me nr. *** prot., datë 22.12.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; dhe me nr. *** prot., datë 28.1.2022 drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

⁸⁴ Kërkesë me nr. *** prot., datë 22.12.2021, drejtuar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; kërkesë me nr. *** prot., datë 22.12.2021, drejtuar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

⁸⁵ Shkresa "Dërgohet informacion" me nr. *** prot., datë 29.12.2021 dhe me nr. *** prot., datë 29.12.2021; Shkresë me nr. *** prot., datë 28.12.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; shkresë kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 7.1.2022, nga Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

⁸⁶ Shkresë me nr. *** prot., datë 9.2.2022.

nr. *** datë 18.11.2021 për veprën penale “Shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe se hetimet në lidhje me këtë procedim vazhdojnë. Gjithashtu, Prokuroria Krujë ka vënë në dispozicion edhe vendimin “Për pranimin e akteve dhe regjistrimin e procedimit penal” datë 18.11.2021.

73.2. Nga administrimi i këtij vendimi kanë rezultuar këto fakte:

(i) Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mbi bazën e kallëzimit të shtetasve M. dhe F. M., si dhe vendimit⁸⁷ të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka regjistruar procedimin penal⁸⁸ nr.*** për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Më tej, mbi bazën e këtyre rrethanave, kjo Prokurori ka çmuar se në zbatim të neneve 83 dhe 84 të K.Pr.Penale nuk është prokurori kompetente për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve⁸⁹ dhe ka vendosur të shpallë moskompetencën për procedimin penal, duke i kaluar aktet prokurorisë së juridiksionit më të afërt që ka kompetencën tokësore për të hetuar rastin.

(ii) Në vijim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë pasi ka vlerësuar faktet në lidhje me procedimin penal nr. ***, ka vendosur pranimin e akteve dhe regjistrimin e procedimit penal me nr. *** për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

(iii) Në lidhje me këtë procedim ku janë kallëzuar disa subjekte rivlerësimi, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit z. Erjon Shehaj paraqiten këto fakte: kallëzuesit, shtetasit M., pretendojnë se janë hetuar dy herë nga Prokuroria Lezhë (sipas procedimit penal nr. ***/2015 si dhe ***/2017) si dhe janë deklaruar fajtor dy herë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprën penale të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal për të njëjtat fakte. Si rrjedhojë sipas kallëzuesve, prokurorët dhe gjyqtarët kanë kryer shkelje ligjore, të parimit të ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën çështje dhe se duhet të mbajnë përgjegjësi penale.

(iv) Nga administrimi i fakteve në lidhje me hetimin dhe gjykimin e shtetasve M ka rezultuar se Prokuroria Lezhë mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A. B., të datës 16.2.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. *** në ngarkim të shtetasve M. dhe F. M. për veprën penale të “Mashttrimit” parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, ku pas përfundimit të hetimeve këta shtetas janë dërguar për gjykim, nën akuzën e “Mashttrimit”.

(v) Pas shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. ***, datë 30.3.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurit F.M. dhe M. M. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 18.10.2017, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në lidhje me fajësinë për të pandehurën M. M., duke e deklaruar atë fajtorë, si dhe të ndryshojë vendimin në lidhje me mënyrën e vuajtjes së dënimit nëpërmjet pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë atë në provë. Gjithashtu, kjo gjykatë ka ndryshuar vendimin, duke e deklaruar të pafajshëm të pandehurin tjetër F.M.

⁸⁷ Vendim nr. ** Regj Them nr. ***, disponimi datë 9.9.2021.

⁸⁸ Nga faktet e cituara konstatohet se kallëzuesit shtetasit M. dhe F. M. kanë kallëzuar pranë Prokurorisë së Posaçme disa subjekte rivlerësimi përfshirë edhe prokurorin Erjon Shehaj për veprat penale “Shpërdorim detyre” dhe “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Pasi janë kryer veprimet verifikuese, Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në vijim pas ankimit të kallëzuesve, Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. ***, datë 9.9.2021 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Prokurorit për mosfillimin e procedimit dhe urdhërimin e prokurorisë të regjistrojë procedimin penal. Në vijim, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Shpërdorim detyre”.

⁸⁹ Ky informacion gjindet edhe tek raporti i KLP-së, ku referon informacionin e marrë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2021.

(vi) Më tej, nga faktet ka rezultuar se pa u shqyrtuar ende kjo çështje para Gjykatës së Apelit, kallëzuesi A. B. përsëri paraqet një kallëzim tjetër penal ndaj të njëjtët shtetasve F.dhe M.M. Në vijim, ky kallëzim regjistrohet pranë Prokurorisë Lezhë me nr. procedimi nr. ***, datë 18.7.2017, në ngarkim të të pandehurve F.dhe M. M. për veprën penale të “Mashtrimit” parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Pas shqyrtimit të fakteve, çështja është dërguar për gjykim pranë Gjykatës Lezhë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. ***, datë 18.10.2019, ka vendosur të deklarojë fajtorë dy të pandehurit për veprën penale të “Mashtrimit”, të kryer në bashkëpunim, duke i dënuar të dy me një masë dënimi prej 5 (pesë) vite burg.

(vii) Mbi bazën e ankimit të shtetasve M është investuar Gjykata e Apelit Shkodër e cila pas shqyrtimit të ankimit, fakteve dhe rrethanave, me vendimin nr. ***, datë 28.9.2020, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurve, me arsyetimin se për të njëjtat fakte të dy të pandehurit ishin gjykuar dhe dënuar më parë, në kuadër të procedimit penal nr. ***/2015, duke u dënuar me vendimet nr. ***, datë 30.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ndryshuar më pas pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 18.10.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

(viii) Në këto rrethana ankuesit kanë kallëzuar disa prokurorë dhe gjyqtarë të përfshirë në këtë çështje, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit që ka përfaqësuar Prokurorinë Lezhë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në konkluzionet përfundimtare të këtij procedimi penal nr. *** dhe nuk ka kërkuar pushimin e procedimit penal, por deklarimin fajtor të tyre.

73.3. Mbi bazën e këtyre fakteve, Komisioni fillimisht verifikoi statusin e kësaj çështjeje, ku vëren se ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër nr. ***, datë 28.9.2020, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, ku nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë⁹⁰, çështja figuron e regjistruar⁹¹ me datën 3.12.2020, për të cilën kjo gjykatë nuk ka disponuar me vendim.

73.4. Më tej, në kuadër të hetimit të plotë, Komisioni kërkoi⁹² dosjen e procedimit penal nr. ***/2017, ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar rolin e përfaqësuesit të akuzës para Gjykatës Lezhë.

73.5. Gjykata e Apelit Shkodër⁹³ vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 28.9.2020, nga administrimi i të cilit evidentohet se kjo gjykatë ka konstatuar se të dyja procedimet (atë të vitit 2015 dhe atë të vitit 2017) kanë pasur për objekt hetimi të njëjtat fakte të kallëzuara nga i njëjti shtetas kundrejt të të njëjtit të kallëzuar, pra i njëjti objekt dhe të njëjtët subjekte, për të njëjtin shkak ligjor, që lidhet me veprën penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, për të cilët janë gjykuar më përpara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë⁹⁴.

73.6. Konkretisht kjo gjykatë citon se e pandehura M.M. përfaqësuese me prokurë e viktimës A. B., duke shpërdoruar besimin e këtij të fundit, nën pretendimin për të blerë pasuri të paluajtshme nën emrin e “*****” sh.p.k., përgjatë harkut kohor 2013-2014 ka përvetësuar në bashkëpunim me bashkëshortin e saj një pjesë të parave nga shuma prej 800,000 eurosh të dërguar asaj nga viktima A. B. për blerjen e pasurive, duke i sjellë pasoja të rënda. Më tej, nga faktet citohet se brenda kësaj shume, përfshihet edhe shuma

⁹⁰ <http://www.gjykataelarte.gov.al/>

⁹¹ Me nr. çështje ***, me status “studim i çështjes”.

⁹² Shkresë me nr. ***prot., datë 17.2.2022, drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër dhe shkresë me nr. *** prot., datë 17.2.2022, drejtuar Gjykatës së Lartë.

⁹³ Shkresë me nr. *** prot., datë 18.2.2022

⁹⁴ Vendime të cilat referohen në këtë material më lart.

që viktimat i ka dhënë të pandehurës M. M. në bashkëpunim me bashkëshortin e saj F. M., duke rezultuar me lidhje kontratash fiktive nën pretendimin e blerjeve të pasurive nr. ***, me sipërfaqe 439 m² dhe nr *** me sipërfaqe 439 m², ndodhur në fshatin ***, si dhe blerjen e pasurisë hotel “****” (fakte që referohen në vendimin nr. ***, datë 30.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, faqe 6-10).

73.7. Të njëjtat fakte në lidhje me përvetësim shumash për të njëjtat pasuri nga të njëjtët të pandehur përgjatë harkut kohor 2013-2014 referohen edhe në vendimin nr. ***, datë 18.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (në faqen 18-23 të vendimit), por në këtë vendim referohen për përvetësim të një shumë tjetër, të shumës prej 330,153 frangash.

73.8. Në përfundim, Gjykata e Apelit shprehet se të dy proceset kanë pasur për objekt të njëjtin fakt, duke vlerësuar se në rastin konkret vepron parimi “*ne bis in idem*”, pasi janë gjykuar të njëjtat veprime dhe të njëjtat pasoja të shkaktuara nga këto veprime përkundrejt të të njëjtëve të pandehur që janë gjykuar më parë me vendimin nr. ***, datë 30.3.2017, prandaj vendimi vijues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. ***, datë 18.10.2019, duhet të prishet dhe çështja duhet të pushohet, për shkak se është rasti që nuk lejon fillimin e procedimit dhe meqë ndjekja penale është ushtruar, është rasti që nuk lejon as vazhdimin e procedimit penal, pasi me vendimin e formës së prerë të pandehurit M. dhe F.M. janë gjykuar për të njëjtin fakt penal.

73.9. Mbi bazën e fakteve të rezultuara gjatë hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje, si dhe të shpjegojë se mbi bazën e cilave rrethana ka paraqitur akuzën në gjyq ndaj shtetasve M. në konkluzionet përfundimtare për procedimin penal nr. ***/2017.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

74. Subjekti ka shpjeguar se në lidhje me këtë çështje, hetimet gjatë fazës paraprake, ngritja dhe njoftimi i akuzës ndaj të pandehurve dhe në përfundim kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq, janë kryer nga një prokuror tjetër i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ndërkohë që ai si prokuror ka qenë i autorizuar për përfaqësimin e akuzës në seancat gjyqësore.

74.1. Nga rrethanat e faktit, akuza nga ana e Prokurorisë është ngritur dhe arsyetuar mbi bazën e mashtrimit mbi një vlerë tjetër monetare, e cila ishte transferuar nga i dëmtuari i veprës penale në favor të bashkëshortëve M. Mbi gjykimin e kësaj çështje, duke qenë prokuror i autorizuar vetëm në fazën e gjykimit të çështjes, mbi kërkimin për dërgimin e çështjes në gjyq, me vendimin nr. ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur të pranojë pjesërisht kërkesën e prokurorit, duke vendosur dërgimin në gjyq të çështjes vetëm për të pandehurën M. M. dhe pushimin e çështjes për të pandehurin F. M. Ai ka sqaruar se, kundër vendimit të mësipërm, duke mos qenë dakord për pushimin e akuzës kundrejt njërit prej të bashkëpandehurve, si prokuror i përfaqësimit të akuzës në gjyq, ai ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur : ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 23.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe pranimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. *** edhe për të pandehurin F.M.. Pra, deri në këtë fazë, në bazë të vlerësimit të provave në gjendjen në të cilën ndodheshin, ishte krijuar bindja mbi plotësinë e veprimeve hetimore të kryera, për t’i dhënë mundësinë gjykatës për t’u shprehur mbi akuzën e ngritur.

74.2. Në lidhje me themelin e çështjes, pas shqyrtimit të çështjes Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka gjetur fajtorë dhe ka dënua të pandehurit F. dhe M. M., si autorë të kryerjes së veprës penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Pavarësisht vendimmarrjes së dhënë nga Gjykata e Apelit Shkodër, për të cilën është ushtruar rekurs, nga vlerësimi në tërësi i akteve dhe provave të administruara nga hetimi

paraparak dhe shqyrtimi gjyqësor, në rastin konkret, megjithë pretendimin e gjykimit për të njëjtën vepër, drejtimi i hetimit dhe më pas gjykimi i kryer në kuadër të procedimit penal nr. ***, i referohej një fakti tjetër penal, që lidhej me mashtrimin e të njëjtave palë, por mbi një shumë tjetër monetare, të ndryshme nga sa ishte hetuar dhe gjykuar njëherë.

74.3. Në përfundim, subjekti është shprehur se, pa dashur të paragjykojë mbi mënyrën e përfundimit të çështjes penale nga shqyrtimi i saj në Gjykatën e Lartë, gjatë përfaqësimit në gjykim të akuzës së ngritur në kuadër të procedimit penal nr. ***, ka vepruar në përputhje të plotë me ligjin dhe bindjen e brendshme të krijuar nga çmuarja në tërësi e akteve dhe provave të vendosura në themel të akuzës për këtë rast.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

75. Trupi gjykues pasi analizoi faktet nga dosja e hetimit dhe shqyrtoi shpjegimet e subjektit, i vlerësoi ato bindëse, për arsye se:

a) Hetimet në lidhje me procedimin penal nr. *** janë kryer nga një prokuror tjetër. Subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me përfaqësimin e akuzës në seancat gjyqësore, i cili në vlerësim të veprimeve hetimore të kryera për këtë çështje i ka kërkuar gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq dhe në vijim, duke qenë i bindur për akuzën e ngritur ndaj të pandehurve pas pranimit të pjesshëm të kërkesës nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për dërgimin në gjyq, vetëm për të pandehurën M. M., subjekti ka proceduar me ankimin e vendimit të kësaj gjykate, duke kërkuar procedimin ndaj të dy të pandehurve. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 3.10.2018, ka vendosur : ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 23.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke pranuar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. *** edhe për të pandehurin F. M.

b) Nga administrimi i fakteve të rezultuara për efekt të procedimit penal nr. ***, është konstatuar se hetimi penal është nisur nga kallëzimi i shtetasit B. mbi bazën e disa fakteve të reja të konstatuara gjatë një procesi civil, të nisur po nga ai kundrejt shtetasve M. me objekt ndër të tjera: “lirim, dorëzim prone”, sipas të cilit kanë rezultuar fakte që lidheshin me shumën e tjera monetare.

75.1. Trupi gjykues, në këtë kontekst, vlerëson se pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk është shprehur ende në lidhje me këtë çështje, për sa konstatohen rrethana të cilat pas hetimit përfaqësojnë një fakt penal tjetër të ri, qoftë kundrejt të njëjtave palë, për të njëjtën vepër penale, këto fakte nuk përbëjnë gjë të gjykuar.

b. Ankesa e paraqitur nga D.G.

76. Shtetasi D.G. ka paraqitur pranë Komisionit disa denoncime të përsëritura ndaj subjektit të rivlerësimit. Ankesat e këtij shtetasi relatojnë shkurtimisht këto fakte:

(i) Me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë informon Komisionin se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal me nr. *** për veprën penale “Shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Laç (Kurbin), më 28.7.2015.

(ii) Me shkresën nr. ***, datë 13.4.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin informon se ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar kallëzimet penale nr. ***, viti 2015 dhe nr. ***, viti 2015 (ardhur për trajtim nga Prokuroria e Tiranës). Kallëzimet janë bashkuar në një të vetëm, numërtuar me nr. ***. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, më 17.7.2015 është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”. Me vendimin nr. ***, datë 22.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka vendosur

pranimin e ankimit të ankuesit D. G. dhe shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, duke urdhëruar vijimin e hetimeve. Me vendimin nr. ***, datë 17.9.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi. Në zbatim të vendimit të mësipërm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim është në fazën e hetimit dhe nuk ka emër autori të regjistruar.

(iii) Më tej, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2021, informon Komisionin se në lidhje me procedimin e mësipërm është kërkuar “Pushim i çështjes” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Kërkesa për pushimin e procedimit penal nr. ***, është në shqyrtim gjyqësor në seancë paraprake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe ende nuk është disponuar me një vendimmarrje.

(iv) Nga administrimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi në denoncimet⁹⁵ konstatohet se Gjykata e Shkallës së Parë Kurbin ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë për pushimin e çështjes, me arsyetimin se ndjekja penale është parashkruar, bazuar në nenin 66, shkronja “ç” të Kodit Penal, pasi veprimet dhe mosveprimet që mund të formësonin anën objektive të veprës penale, parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal kanë ndodhur në mars të vitit 2015. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankimi shtetasi D.G.

(v) Nga administrimi i dosjes së procedimit penal nr. ***, të vitit 2018, konstatohen këto fakte: Mbi bazën e ankimeve/kallëzimeve të përsëritura të paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme nga shtetasi D.G. ndaj subjektit të rivlerësimit dhe ish-drejtuesit të Prokurorisë Lezhë z. P. V. dhe pas kalimit për kompetencë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, është regjistruar kallëzimi penal me nr. ***, datë 17.7.2015, ndaj subjektit të rivlerësimit dhe z. P.V. për veprën penale “Shpërdorim detyre”, sipas nenit 248 të Kodit Penal, duke pretenduar se këta funksionarë kanë kryer me dashje shkelje të rënda të ligjit, duke vepruar dhe mosvepruar në kundërshtim me K.Pr. Penale, duke shpërdoruar detyrën në një çështje penale të filluar kundër kallëzuesit për veprën penale parashikuar nga neni 317 të Kodit Penal. Çështja penale e regjistruar në emër të shtetasit D.G. për veprën “Kanosja e gjyqtarit” është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Në lidhje me këtë çështje, paraqiten shkurtimisht këto fakte:

(vi) Në datën 3.3.2015, në Prokurorinë Lezhë është administruar një zarf, ku brenda tij kanë qenë dy letra drejtuar ish-drejtuesit të Prokurorisë Lezhë z. P. V. dhe subjektit të rivlerësimit me përmbajtje në dukje kërcënuese. Pasi janë kryer verifikimet e para, është caktuar për hetimin në lidhje me këtë shkresë subjekti i rivlerësimit, i cili në datën 11.3.2015 ka regjistruar procedimin penal me nr. ***, në ngarkim të shtetasit D.G. për veprën penale “Kanosja e gjyqtarit” dhe në vijim është urdhëruar ndalimi i tij, i cili është ekzekutuar në datën 13.3.2015. Me vendimin nr. ***, datë 14.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vleftësuar të ligjshëm ndalimin dhe ka caktuar ndaj shtetasit D.G. masën e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

76.1. Në vijim, subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 2.4.2015 ka vendosur moskompetencën dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për hetime të mëtejshme. Mbi bazën e ankimit të shtetasit D. G., Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 20.4.2015, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 14.3.2015, me arsyetimin se vendimi për caktimin e masës së sigurimit është marrë mbi bazën e akteve absolutisht të pavlefshme, bazuar në nenin 128 të K.Pr Penale, pasi subjekti i rivlerësimit kishte interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje dhe sipas nenit 17 dhe 26 të K.Pr. Penale duhet të hiqte dorë. Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria pranë

⁹⁵ Denoncime regjistruar me nr. *** prot., datë 9.11.2021, si dhe me nr. *** prot., datë 18.1.2022, të shtetasit D.G.

Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, lidhur me procedimin e kaluar për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lezhë me vendimin e datës 5.6.2015 ka vendosur pushimin e hetimeve për veprën penale “Kanosja e gjyqtarit” me autor të dyshuar shtetasin D.G.

76.2. Komisioni nga analizimi i fakteve në lidhje me këtë procedim dhe veprimeve/mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, pa u ndalur tek pasojat e veprimeve procedurale të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, të cilat duket se janë rregulluar nga gjykata më e lartë, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa duket se subjekti, nëpërmjet angazhimit/pranimit për hetimin e një çështjeje penale në të cilën pretendohet se referohej emri i tij, ka cenuar standardet e etikës dhe vlerave profesionale që duhet të manifestojë një magjistrat tek publiku për garantimin e një drejtësie të paanshme, pasi ishte në rrethanat e interesit të drejtpërdrejtë në lidhje me këtë çështje dhe bazuar në nenin 17, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale, kishte detyrimin të hiqte dorë nga hetimi i çështjes penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

77. Subjekti, në shpjegimet e tij, ka sqaruar se kjo çështje i është caktuar nga drejtuesi i Prokurorisë, që në zbatim të ligjit kohës, prokuroria i ushtronte kompetencat mbi bazë hierarkie. Për shkak të kalimit të afateve për kryerjen e verifikimeve ka proceduar me regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale të “Kanosja e gjyqtarit”, parashikuar nga neni 317 i Kodit Penal. Ndërkohë që nga vlerësimi në tërësi i rrethanave të dala në dritë deri në atë moment, si edhe nisur nga sjellja e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale konkrete, është urdhëruar ndalimi i personit të dyshuar për një krim.

77.1. Pas ekzekutimit të urdhrit nga Policia Gjyqësore, brenda afateve ligjore ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë “Vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasin D.G.”, i cili është pranuar. Pra, sipas subjektit, në vlerësim të akteve të mbledhura deri në datën 13.3.2015, ka vlerësuar se ekzistonin kushtet për caktimin e masës së sigurimit përkatës ndaj të dyshuarit, veprime dhe kërkime të cilat janë vlerësuar të ligjshme dhe si të tilla janë miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pas kryerjes së veprimeve procedurale penale si më sipër, në datën 2.4.2015, ka çmuar dhe vendosur shpalljen e moskompetencës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe dërgimin e akteve në prokurorinë kompetente.

77.2. Në lidhje me konfliktin e interesit, ai ka sqaruar se pasi ka lexuar përmbajtjen e kallëzimit, e cila nuk paraqiste dhe as ngrinte ndonjë pretendim kundrejt tij si prokuror që të kishte hetuar deri në atë moment si subjekt procedural penal (në çfarëdo pozite) ndonjë prej shtetasve E. M., A. Gj., D.G., S. G. apo persona të tjerë të cituar në atë kallëzim, ka vijuar më tej me hetimin. Ai ka theksuar se si prokuror nuk e ka konsideruar asnjëherë veten si subjekt i përfshirë, qoftë në pretendimet e kallëzimit dhe as si i interesuar, në kuptim të nenit 17/1/a të K.Pr.Penale dhe prandaj nuk ka qenë në kushtet e nenit 17 të K.Pr.Penale. Për të provuar në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave⁹⁶ disa akte, sipas të cilit, vërtetohet se subjekti nuk ka hetuar ndonjëherë çështje në lidhje me shtetasit e mësipërm.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

⁹⁶ Shkresë nr. *** prot, datë 18.3.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2016, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme, drejtuar shtetasit D.G.; shkresa nr. *** prot., datë 17.3.2022, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme; shkresa nr. *** prot., datë 17.3.2022, lëshuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; shkresa nr. *** prot., datë 18.3.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

78. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit si dhe vlerësoi me objektivitet faktet e paraqitura, çmon se në lidhje me këtë çështje janë konstatuar rrethana të cilat sipas legjislacionit në fuqi ndalojnë ushtrimin e veprimtarisë hetimore. Neni 17, pika 1, shkronja “a” dhe 26, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale rregullon detyrimin e prokurorëve për heqjen dorë nga hetimi i çështjes në rastin kur ka interes në procedim. Pavarësisht se subjekti shpjegoi dhe paraqiti vërtetime për të provuar mospasjen e interesit me shtetasit të cilët referohen në kallëzim, trupi gjykues vlerëson se, emri i referuar në letrën e regjistruar si material kallëzues në Prokurori duhej të verifikohet nga subjekti si një eventualitet që mund të lidhet me personin e tij, e si i tillë përbënte indicie të mjaftueshme për të proceduar me heqjen dorë, në kuptim të nenit 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale.

78.1. Megjithëse organi kompetent i kohës, që ka verifikuar përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve objekt ankese, nuk ka verifikuar përgjegjësi për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se këto rrethana nuk e bëjnë subjektin të papërshtatshëm për kriterin profesional, bazuar në parimin e proporcionalitetit, për sa subjekti në një kohë shumë të shkurtër mori masa për heqjen dorë nga shqyrtimi i themelit të çështjes, duke ia kaluar për kompetencë prokurorisë më të afërt. Në çmim të këtij trupi gjykues vlerësohet gjithashtu se praktika që lidhet me ankesën e shtetasit D.G. duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e mëtejshëm në kuadër të legjislacionit, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

c. Ankesë nga shtetasi Gj.M.⁹⁷

79. Komisioni, pas analizimit të kallëzimit të këtij shtetasi ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “Shpërdorim detyre”, në lidhje me dërgimin në gjyq të këtij shtetasi me dokumente të falsifikuara, ankesa të cilat janë paraqitur edhe përmes denoncimit pranë Komisionit, nuk gjeti indicie për subjektin e rivlerësimit referuar kriterit profesional.

GJETJE TË TJERA

80. Gjatë hetimit për kontrollin e figurës, referuar indicieve të marra nga autoritetet verifikuese, Komisioni ka administruar disa dosje penale⁹⁸ në kuptim të nenit 41/4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit parashikohet se: “*Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale*”.

80.1. Komisioni, pasi analizoi procedimin penal nr. ***⁹⁹, ku janë dërguar për gjykim shtetasi L. F. dhe të tjerë, akuzuar për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Shpërdorim detyre”, kallëzimin e shtetasit D.P., për të cilin vijnë hetimet¹⁰⁰, si dhe procedimin penal me nr. ***, dërguar nga Prokuroria Lezhë me shkresën nr. *** prot.,

⁹⁷ Protokolluar me numër *** datë 29.2.2016, pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

⁹⁸ Me shkresën me nr. *** prot., datë 28.1.2022, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe shkresë me nr. *** prot., datë 28.2.2022, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; shkresë me nr. *** prot., datë 8.2.2022, u kërkuan dosjet e plota hetimore dhe informacion në lidhje me statusin e këtyre çështjeve në gjykatën kompetente.

⁹⁹ Ardhur informacioni me shkresën nr. ***prot., datë 22.2.2022 nga Prokuroria Lezhë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë shkresa nr. *** prot., datë 9.2.2022.

¹⁰⁰ Për arritjen e këtij konstatimi, Komisioni i referohet edhe vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me nr. ***, datë 17.4.2019, ardhur në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2022.

datë 2.2.2022, konstatoi se nga administrimi i fakteve dhe veprimeve hetimore të kryera, nuk rezultojnë indicie në kuadër të kriterit profesional për subjektin rivlerësimit.

80.2. Në lidhje me procedimin penal nr. ***, dërguar nga Prokuroria Lezhë me shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2022, me prokuror subjektin e rivlerësimit, kanë rezultuar se:

(i) Mbi bazën e referimit¹⁰¹ të Drejtorisë së Policisë Lezhë, në datën 5.11.2021 është regjistruar procedimi penal për veprën penale parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, në ngarkim të shtetasit P. Gj., pasi në datën 5.11.2021 nga shërbimet e Policisë Lezhë është konstatuar se drejtuesi i mjetit me targë ***, shtetasi P. Gj., po lëvizte me mjetin e tij pranë vendit të quajtur “****”, pranë Bashkisë Lezhë, nën efektin e pijeve alkolike.

Në lidhje me këtë çështje janë kryer këto veprime hetimore:

(ii) Në datën 5.11.2020¹⁰² është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasit P.Gj., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, sipas nenit 291 të Kodit Penal, pasi është kapur në gjendje të dehur dhe nuk ka pranuar t’i bindet urdhrave të punonjësve të policisë për t’u ndaluar. Në këtë datë është kryer edhe kontrolli personal i këtij shtetasi.

(iii) Po në datën 5.11.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal detyrim për paraqitje në polici, sipas nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale, ku në vijim, me vendimin nr. ***, datë 6.11.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë Lezhë për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit P. Gj. në datën 5.11.2020, caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për paraqitje në polici gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Lezhë”, si dhe lirimin e këtij shtetasi nga dhomat e paraburgimit.

(iv) Në vijim, në datën 5.11.2020, subjekti i rivlerësimit bazuar në nenin 301/2 i Kodit të Procedurës Penale ka vendosur vleftësimin e sekuestros së provave materiale (automjet, leje qarkullimi, policë sigurimi, printim nga sistemi *e-gjoba* mbi të dhënat e lejes së drejtimit, certifikatë kontrolli teknik me nr. ***) dhe më vonë pas kryerjes së veprimeve procedurale, ka urdhëruar kthimin e tyre.

(v) Më tej, subjekti i rivlerësimit bazuar në nenin 201/a pika 10¹⁰³ e Kodit të Procedurës Penale “Marrja e detyrueshme e kampionëve biologjikë”, ka vendosur¹⁰⁴ marrjen e kampionëve të gjakut pranë Spitalit Rajonal Lezhë, me qëllim kryerjen e ekspertimit për përcaktimin e nivelit të alkoolit në gjak të shtetasit P. Gj., ku në zbatim të vendimit është kryer sekuestrimi¹⁰⁵ i kampionëve të gjakut dhe i janë dërguar ekspertit toksikolog për kryerjen e ekspertimit toksikologjik. Me aktin toksikologjik ligjor nr. ***, datë 24.11.2020, është konkluduar se “*në mostrën e gjakut të marrë shtetasit P. Gj. është zbuluar alkol etilik në vlerën mesatare 1.751 gr/l*”.

(vi) Në datën 6.11.2021, subjekti i rivlerësimit brenda afatit ligjor prej 48 orësh, ka kërkuar para gjykatës kompetente vleftësimin e vendimit për marrjen e kampionëve biologjikë, bazuar në nenin 201/a pika 11 e Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Rrethit

¹⁰¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.11.2020.

¹⁰² Referuar procesverbalit të datës 5.11.2020.

¹⁰³ Në raste të ngutshme, kur ka arsye për të besuar se vonesa mund të shkaktojë humbjen ose dëmtimin e vërtetësisë së provës, vendimi merret nga prokurori, i cili mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të personit.

¹⁰⁴ Me vendimin e datës 5.11.2020. Ky vendim është marrë nga subjekti i rivlerësimit, duke vlerësuar rrethanat e refuzimit të personit të ndaluar për kryerjen e testit të alkoolit.

¹⁰⁵ Referuar “procesverbalit për marrjen dhe sekuestrimin e kampionit të gjakut” të datës 5.11.2020.

Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. ***, datë 6.11.2020 ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë, duke vlerësuar të ligjshëm vendimin e datës 5.11.2020, për marrjen e kampionëve biologjikë.

(vii) Pasi janë kryer edhe veprimet e tjera hetimore si: pyetja¹⁰⁶ e të pandehurit dhe administrimi i disa akteve¹⁰⁷, si dhe pasi ka vlerësuar rrethanat dhe provat e mbledhura, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 1.12.2020 ka vendosur për marrjen si të pandehur të shtetasit P. Gj.për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe njoftimin e akuzës, për të cilën rezultoi se i pandehuri është njoftuar me datën 4.12.2020.

(viii) Në vijim, subjekti i rivlerësimit me kërkesën e datës 7.12.2020 ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***/2020. Me vendimin nr. ***, datë 16.03.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre muaj burgim; Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale i ulet 1/3 e dënimit me 2 muaj burgim; Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e tij në provë për një periudhë 4-mujore, duke detyruar të pandehurin të mos kryejë veprën tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës së vendbanimit të tij.*

80.2.1. Nga vlerësimi i dosjes hetimore, Komisioni ka konstatuar të cituara edhe disa fakte të tjera¹⁰⁸ të cilat i referohen rrethanave të materialit kallëzues të policisë. Në materialin referues, patrulla e policisë shpjegon se i proceduari nuk i është bindur shenjë së tyre për të ndaluar dhe më pas mospranimi për të kryer testin e alkoolit në lidhje me përdorimin e alkoolit gjatë drejtimit të mjetit.

80.2.2. Duke lindur dyshime se ndaj të proceduarit subjekti i rivlerësimit duhet të kishte kryer hetimi edhe në drejtim të veprës penale të “Mosbindjes ndaj urdhrave të policisë”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa u konstatua se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar mbi faktet e veprimeve dhe mosveprimeve të shtetasit P. Gj. ndaj urdhrave të punonjësve të policisë që kanë qenë në shërbim gjatë kohës së patrullimit të këtij shtetasi me automjetin e tij, si dhe as nuk ka arsyetuar se përse është i mjaftueshëm dërgimi për gjykim i të pandehurit për akuzën e vetme në ngarkim të tij “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”; (ii) moskryerja e një hetimi të plotë nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me faktet e dokumentuara duket se ka sjellë për pasojë lehtësimin e pozitës së të pandehurit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

81. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kur ka ndodhur ngjarja, në datën 5.11.2020,0 ka qenë prokuror i gatshëm, ku është lajmëruar nga shërbimet e policisë pranë DVP-së Lezhë, në lidhje me konstatimin në drejtimin e një automjeti, të një personi të dyshuar të dehur, që nuk pranon kryerjen e matjes së nivelit të alkoolit me aparatën “Drager”. Mbi këtë fakt, ka kërkuar shoqërimin e personit të dyshuar pranë ambjentëve të spitalit, me qëllim kryerjen e verifikimeve në lidhje me përdorimin dhe nivelin e alkoolit në gjak, përmes ekzaminimit mjekoligjor, të kampionit biologjik të personit (përmes gjakut). Ai ka sqaruar veprimet hetimore të ndjekura në lidhje me këtë çështje ku pas vlerësimit të fakteve i është drejtuar Gjykatës me kërkimin për kalimin e çështjes në gjyq. Me vendimin

¹⁰⁶ Sipas procesverbalin e datës 4.12.2020.

¹⁰⁷ Shkresë informacioni i marrë nga DPSHTRR-ja në lidhje me disponimin e lejes së drejtimit për shtetasin P.Gj, vendimin për shqyrtimin e kundërvajtjes të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë bashkë me dokumentacionin shoqëruar.

¹⁰⁸ Referuar në informacionin për referimin e veprës penale të datës 5.11.2020.

nr. ***, datë 16.3.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka vendosur : *Deklarimin fajtor të të pandehurit P. Gj., për kryerjen e veprës penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij....”*.

81.1. Subjekti ka shpjeguar procedurën në lidhje me matjen e alkoolit në gjak sipas parashikimeve në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), konkretisht në nenet 184 dhe 185 të tij. Subjekti ka shpjeguar se procedura për marrjen e kampionit biologjik, përcjellja për ekspertim dhe dhënia e konkluzionit përkatës mjekoligjor, është kryer në përputhje me të gjitha garancitë ligjore që lidhen me: njoftimin e të dyshuarit; pjesëmarrjen e domosdoshme të mbrojtësit; vendimin e gjykatës për vleftësimin e vendimit të marrjes së kampionit biologjik etj. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se refuzimi në lidhje me përdorimin e këtij aparati përfshihet në tërësinë e sjelljeve subjektive të personit, të cilat në thelb të tyre kanë mospranimin e aplikimit të kësaj metode matjeje për një sërë arsyesh objektive dhe subjektive të personave, sikurse mund të jetë: frika, pasiguria, mosbesimi kundrejt saj. Në këtë drejtim, mospranimi i përdorimit të matësit *drager* (përmes fryrjes së aparatit për një periudhë kohe e përmes disa provave), në thelb nuk përbën mosbindje ndaj urdhrimit të policisë për t’u verifikuar mbi përdorimin e alkoolit, por mospranim të aplikimit të kësaj metode, veprime të cilat nuk përbëjnë elementet e ndonjë figure vepre penale si “Mosbindje ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik”, e parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal.

81.2. Subjekti ka shpjeguar se, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, sipas neneve 331 - 332/gj, të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, veprimet e prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake, qoftë për sa i përket pushimit të çështjes/akuzës (kur procedohet për krime), ashtu edhe kur përcillet çështja për gjykim, vlerësohen dhe verifikohen mbi bazueshmërinë e tyre në ligj dhe prova, nga gjyqtari i seancës paraprake. Në rastin konkret, Gjykata e ka vlerësuar të ligjshëm procedurën e hetimit dhe përfundimet e arritura në përfundim të hetimit të kryer. Nëse Gjykata do të kishte një vlerësim të ndryshëm, mund të kishte vendosur plotësimin e hetimeve, duke përcaktuar veprimet e nevojshme apo drejtimin e tyre.

81.3. Në përfundim, subjekti ka shpjeguar se të gjithë elementet e veprimeve dhe mosveprimeve të të dyshuarit konkret në këtë procedim penal, përbënin elementet e figurës së veprës penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (në gjendje të dehur), sipas parashikimit të nenit 291 të Kodit Penal dhe se nga ana tjetër, veprimet e konstatuara në lidhje me mospranimin e kryerjes së matjes së alkoolit, përmes aparaturës është vlerësuar dhe çmuar si një sjellje, e cila nuk shkonte në drejtim të mosbindjes ndaj urdhrimit të policisë për verifikimin e alkoolit. Ai ka theksuar se ka hetuar, ka mbledhur prova dhe të dhëna dhe në përfundim, ka njoftuar akuzën në bazë të çmuarjes dhe krijimit të bindjes së brendshme se i pandehuri ka kryer veprën penale përkatëse. Çmuarja e provave në bazë të bindjes së brendshme është konsideruar dhe vleftësuar e bazuar edhe nga Gjykata, e cila në përfundim ka bërë vendimmarrjen përkatëse që shkon në përputhje me qëndrimin dhe kërkimin e prokurorisë.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

82. Trupi gjykues vlerëson se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm në lidhje me gjetjet e Komisionit. Nëpërmjet procedurës së ndjekur për matjen e alkoolit për të pandehurin ai shpjegoi se, pavarësisht se ka pasur kundërshtime nga ana e të pandehurit ndaj urdhrave të punonjësve të policisë, këto kundërshtime lidhen me përpjekjet e tij për mos iu bindur kryerjes së testit të alkoolit dhe në këtë kuptim, refuzimi i të pandehurit për ta kryer testin, nuk përbën vepër penale.

82.1. Nëpërmjet veprimeve hetimore të ndjekura në lidhje me këtë rast dhe procedimin me dërgimin në gjyq për të pandehurin për veprën penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, subjekti i rivlerësimit tregoi për trupin gjykues bindjen e tij për përgjegjësinë penale që i është atribuar të pandehurit. Ky konstatim përforcohet edhe me miratimin nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake të veprimeve hetimore të ndjekura nga subjekti si dhe të gjyqtarit të seancës gjyqësore për deklarin fajtor të të pandehurit, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit.

DENONCIMET

83. Pranë Komisionit janë regjistruar disa denoncime për subjektin e rivlerësimit, të cilët janë administruar dhe vlerësuar nga Komisioni në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

83.1. Komisioni, pas shqyrtimit të denoncimeve të shtetasit A. S.¹⁰⁹ për të cilin, pas shpjegimeve, subjekti paraqiti prova se nuk ka pasur në hetim asnjë nga materialet kallëzuese të paraqitura nga ky shtetas dhe nuk ka kryer veprime procedurale penale në lidhje me to, denoncimeve të shoqërisë “***”¹¹⁰; dy denoncime nga shtetasi D.P.¹¹¹, një denoncimi nga shtetasi F. C.¹¹², për të cilat janë duke u zhvilluar ende hetime dhe janë në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit; denoncimit të paraqitur nga 14 shtetas¹¹³ dhe tri denoncime të përsëritura të shtetasit Gj.M.¹¹⁴, të cilët kanë pretenduar se aktet e prokurorit janë ngritur mbi dokumente të falsifikuara, denoncimit nga shtetasja Xh. J.¹¹⁵, çështja e së cilës është në shqyrtim nga gjykata kompetente, si dhe një denoncim anonim¹¹⁶, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.2.2022, nuk u gjetën indicie për hetime të mëtejshme në lidhje me kriterin profesional për subjektin e rivlerësimit, ndërsa në zbatim të nenit E “Vlerësimi i aftësive profesionale” pika 2, të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim nga subjektet e rivlerësimit.

Komisioni vlerësoi të ndalet në denoncimet e mëposhtme:

83.2. Dy denoncime paraqitur nga shtetasit N. dhe S. M.¹¹⁷ paraqitur në formë akti “kallëzimin penal” drejtuar institucioneve të drejtësisë ndaj subjektit të rivlerësimit dhe disa subjekteve të tjera të rivlerësimit, të referuar se kanë shpërdoruar detyrën, duke mos hetuar në lidhje me kallëzimin ndaj shtetasve Z.H.dhe E. H. dhe se subjekti i rivlerësimit ka ndarë procedimin penal në kundërshtim me ligjin. Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur dokumentacion mbështetës. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime.

83.2.1. Subjekti paraqiti shpjegimet e tij në lidhje me ndjekjen e procedurës hetimore në lidhjen me këtë çështje, ku janë kallëzuar disa subjekte rivlerësimi. Ai ka shpjeguar se ka vendosur ndarjen dhe veçimin e çështjes, duke kaluar aktet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përse i përket materialit kallëzues të referuar në ngarkim të shtetasve Z.dhe E. H. si prokuroria kompetente. Ndërsa në lidhje me rrethanat e kallëzuara në ngarkim të prokurorëve të cilët e ushtrojnë detyrën pranë Prokurorisë Shkodër, janë

¹⁰⁹ Nr. ***5 prot., datë 5.11.2021 dhe me nr. *** prot., datë 31.1.2022.

¹¹⁰ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.2.2021.

¹¹¹ Me nr. *** datë 18.11.2019, me nr. *** prot., datë 7.7.2021.

¹¹² Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.1.2022.

¹¹³ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.7.2018.

¹¹⁴ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2020; me nr. ***prot., datë 5.11.2021 dhe me nr. *** prot., datë 9.11.2021.

¹¹⁵ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.3.2019.

¹¹⁶ Në formularin e denoncimit referohet si qytetari anonim.

¹¹⁷ Protokolluar në Komision, përkatësisht me nr. *** prot., datë 23.10.2019 dhe me nr. *** prot., datë 27.5.2019.

kryer verifikimet dhe hetimet e nevojshme, duke qenë prokuroria kompetente për hetimin e kësaj lënde kallëzimi.

83.2.2. Në përfundim të hetimeve subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, e cila ka vendosur: pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal nr. ***. Mbi ankimin e ushtruar Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 12.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në mbështetje të shpjegimeve paraqiti prova: i) vendim “Për ndarjen e çështjes”; ii) vendim “Për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve”; iii) kërkesë “Për pushimin e çështjes penale nr. ***, datë 24.7.2018”; iv) vendimi nr. ***, datë 12.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 18.3.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër;

83.3. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave paraqitur nga subjekti, i vlerësoi ato bindëse. Nga verifikimi i akteve rezultoi se subjekti i rivlerësimit me të drejtë ka proceduar për ndarjen e çështjeve për shkaqe kompetence, duke proceduar me hetimin vetëm të procedimit në ngarkim të prokurorëve të prokurorisë Shkodër, pasi Prokuroria Lezhë është kompetente sipas ligjit si prokuroria më e afërt me juridiksion territorial, ndërsa për veprat e tjera “Fshehja e të ardhurave” etj., të kallëzuara të kryera në bashkëpunim në ngarkim të shtetasve Z.H. dhe E.H. dhe familjarëve të tyre, ka proceduar me veçimin e tyre dhe dërgimin për kompetencë Prokurorisë Shkodër si prokuroria kompetente.

Dy denoncime të përsëritura të shtetasit Gj. N.¹¹⁸

84. Denoncuesi i ka paraqitur denoncimet në cilësinë e avokatit për klientin e tij A. R., duke referuar se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të paligjshme dhe korruptive kualifikimin ligjor për dy vepra penale ndaj të pandehurit A. R., të cilat janë të kundërta me rrethanat e ngjarjes dhe me akuzat ndaj tij parashikuar nga neni 278 dhe neni 294/2-22 të Kodit Penal. Për rrjedhojë, nga ushtrimi i paligjshëm i ndjekjes penale, i pandehuri është dënuar padrejtësisht me burgim prej dy vitesh, duke shkelur kështu të drejtat e njeriut. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij ka konsumuar veprën penale “Fillim i paligjshëm i ndjekjes penale”, parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal, duke i kërkuar Komisionit marrjen e masave ndaj subjektit të rivlerësimit.

84.1. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet e ndjekura në lidhje me këtë çështje. Ai ka sqaruar se shtetasi A. R. është kapur në flagrancë nga shërbimet e policisë në datën 30.8.2016 në vendin e quajtur ***, Lezhë. Në bazë të materialit kallëzues të përcjellë nga Komisariati i Policisë Lezhë pranë DVP-së Lezhë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 30.08.2016, për veprat penale të “Peshkimi i paligjshëm, mbetur në tentativë” dhe “Prodhim dhe mbajtja pa lejë e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuara nga nenet 204-22 dhe 278/1 të K.Penal. Në bazë të materialit të referuar ka rezultuar se është shtetasi A.R, i cili ishte duke kryer peshkim me lëndë eksplozive të përgatitura në mënyrë artizanale (nitrat dhe kapsolle detonatore së bashku me fitilin zjarrpërcjellës të futur në një shishe). Mbi këto materiale të sekuestruara është urdhëruar kryerja e ekspertimit teknik, sipas të cilit është konkluduar se lënda objekt ekspertimi klasifikohet në lëndë eksplozive artizanale nga përzierja e nitritit të amonit me karburant, që bën pjesë në grupin e lëndëve shpërthyes të fuqisë së ulët.

84.2. Pas regjistrimit të procedimit penal është kërkuar në gjykatë vleftësimi i arrestit të kryer nga policia gjyqësore dhe caktimi i masës së sigurimit personal ndaj të dyshuarit A.

¹¹⁸ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.7.2018 dhe me nr. *** prot., datë 1.2.2022.

R.. Gjykata i ka gjetur të ligjshme veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit, duke pranuar kërkesat dhe ligjëruar arrestin në flagrancë, duke caktuar edhe masën e sigurimit personal përkatës. Ai ka shtuar se në lidhje me veprën penale “Peshkimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 204 i K.Penal, në zbatim të ligjit nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie”, është vendosur pushimi i akuzës. Ndërkohë, për veprën penale të “Prodhimi dhe mbajtja pa lejë e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal, hetimet janë kryer të plota duke i kërkuar në përfundim gjykatës, gjykimin e çështjes. Me vendimin nr. ***, datë 13.04.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur : Deklarimin fajtor të pandehurit A. R. për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe mbajtja pa lejë e armëve luftarake dhe e municionit”, e parashikuar nga neni 278/1 të Kodit Penal...”. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave: vendim nr. ***, datë 13.4.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

84.3. Trupi gjykues, vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe shteruese. Subjekti i rivlerësimit arriti të provonte se kishte kryer veprimet hetimore për zbardhjen e të vërtetës dhe në përfundim është bazuar edhe në konkluzionet e ekspertit për procedimin me gjykimin e të pandehurit A. R., për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”. Ndërsa, për veprën tjetër penale “Peshkim i paligjshëm”, në zbatim të ligjit nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie”, ka vendosur pushimin e akuzës.

84.4. Denoncimi i dytë shtetasit Gj. N.¹¹⁹, i cili në cilësinë e avokatit ka denoncuar subjektin e rivlerësimit se nuk ka zbatuar nenin 291 të Kodit Penal për veprën penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, duke kërkuar dënim më të lartë ndaj shtetasit P.Sh., 8 muaj burgim, pasi është kapur me motorcikël 49 kubikësh, pa leje drejtimi, si dhe ka pretenduar se edhe pse është kërkuar nga prokurori arrest shtëpie, duke ndryshuar masën e arrestit në burg, ky shtetas për këtë vepër penale ka vuajtur 5 muaj e 10 ditë burgim, duke u shkelur për rrjedhojë liritë dhe të drejtat themelore. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit.

84.5. Subjekti ka shpjeguar se denoncimi përmban rrethana të pasakta. Ai ka sqaruar se ndryshe nga sa referohet në këtë denoncim, hetimi dhe dënimi i personit P.Sh. ka ndodhur për faktin penal të drejtimit pa lejen përkatëse (patentës) të motorit me fuqi motorike 85 m³. Nëse do të ishin të vërteta rrethanat për drejtimin e një motomjeti me fuqi motorike 49 m³ (pra më pak sesa 50 m³), në përputhje me nenin 115 të Kodit Rrugor, nuk do të ishim para ndonjë vepre penale. Subjekti ka sqaruar më tej në lidhje me rrethanat e kësaj çështje ku mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga Komisariati i Policisë Lezhë, në Prokurori është regjistruar çështja penale me nr. ***, datë 26.02.2018, për veprën penale të “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, në ngarkim të shtetasit P. Sh..

84.6. Mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata ka vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë të shtetasit P.Sh., duke caktuar edhe masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale. Pas kryerjes së hetimeve dhe dokumentimit të plotë të ngjarjes dhe rrethanave të hetimit, pas përfundimit të hetimit dhe njohjes me garancitë procedurale, subjekti i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për kalimin e çështjes në gjykim, ku me vendimin nr. ***, datë 5.7.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur: deklarin fajtor të të pandehurit P.Sh. për kryerjen e veprës penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim. Ai ka sqaruar gjithashtu se, në lidhje me pretendimin e denoncuesit për mbajtjen e një qëndrimi më të ashpër, duke vlerësuar veprën e kryer dhe

¹¹⁹ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.9.2018.

rrezikshmërinë e saj, ky qëndrim ka qenë në përputhje me rrethanat, pasi i pandehuri disa muaj më herët ishte i dënuar për të njëjtën veprë penale me vendim gjyqësor të formës së prerë. Si përfundim, ai ka konkluduar se ka mbajtur një qëndrim objektiv dhe plotësisht të mbështetur në ligj e në prova të rezultuara në lidhje me këtë të pandehur në kuadër të procedimit penal nr. ***. Në mbështetje të shpjegimeve ka paraqitur në cilësinë e provës: vendimin nr. ***, datë 5.7.2018, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, lënë në fuqi me vendimin nr. *** të Gjykatës së Apelit Shkodër.

84.7. Trupi gjykues i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore dhe në përfundim ka kërkuar para gjykatës procedimin në ngarkim të shtetasit P.Sh., duke kërkuar dënimin e tij me 9 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e 1/3 e dënimit të tij. Nga administrimi i akteve rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në përputhje me rrethanat e rrezikshmërisë së të pandehurit, pasi ai ka qenë recidivist.

Dy denoncime paraqitur nga shtetasja B. K.¹²⁰

85. Denoncuesja ka paraqitur ankim/denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit për faktin se subjekti i rivlerësimit nuk e ka informuar këtë shtetase në lidhje me kallëzimet e përsëritura që ka kryer ndaj shtetasit Gj. Gj., për veprat penale “Kanosje” dhe “Falsifikim dokumentash” si dhe për kallëzimet ndaj shtetasve Gj.dhe N. N. për veprën penale “Falsifikim të dokumenteve” të shoqërisë “****” sh.p.k., nga veprimet e të cilëve i ka ardhur një dëm i konsiderueshëm kësaj shoqërie. Denoncuesja, gjithashtu ka denoncuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka urdhëruar kryerjen e ekspertimeve grafike të nënshkrimeve ndaj shtetasve Gj. dhe N. N., duke qenë se ishin kallëzuar për veprën penale “Falsifikim dokumentacioni”, por është mjaftuar vetëm në administrimin e nënshkrimeve të tyre. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit.

85.1. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, në lidhje me këtë çështje, si fillim është ngarkuar si prokuror i çështjes duke kryer një sërë veprimesh hetimore, me qëllim hetimin e rrethanave të kallëzuara dhe identifikimin e dokumentimin e ekzistencës së veprave penale mbi të cilat ishte regjistruar edhe procedimi penal. Ndërkohë që çështja penale ndodhej në hetim, nga ana e kallëzuesit dhe bashkëshortes së tij shtetas B. K. janë paraqitur në vijim kërkesa dhe ankesa kundrejt tij, duke u ngritur pretendime në lidhje me hetimet e kryera, pavarësisht se çështja ishte në hetim dhe për shkak të kompleksitetit të pretendimeve dhe dinamikës së veprimeve, ende nuk ishte konkluduar me përfundimin e hetimeve. Në këto kushte ai ka sqaruar se për të evituar çdo lloj paragjykimi për njëanshmëri ka proceduar me kërkesën për zëvendësim drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë, i cili e ka konsideruar të bazuar kërkesën, duke e zëvendësuar nga hetimi i mëtejshëm i kësaj çështje me një prokuror tjetër të kësaj prokurorie. Në lidhje me këtë çështje, subjekti paraqiti në cilësinë e provave: i) formular për trajtimin e materialit kallëzues ***; ii) urdhër për regjistrimin e procedimit penal, datë 11.7.2016; iii) kërkesë për heqje dorë, datë 20.9.2017; iv) kërkesë “Për pushimin e çështjes nr. ***”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

85.2. Trupi gjykues i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit. Pretendimet e denoncueses janë formalizuar edhe gjatë fazës së hetimit, ku subjekti i rivlerësimit ka proceduar me kërkesën për heqje dorë, e cila është miratuar nga drejtuesi i Prokurorisë.

Denoncim i shtetasit M. P.¹²¹

¹²⁰ Protokolluar në Komision përkatësisht me nr. *** prot., datë 22.2.2019 dhe me nr. *** prot., datë 28.2.2020.

¹²¹ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.2.2022.

86. Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit se, nuk ka kryer hetime të plota dhe se është munduar të fshehtë të vërtetën e ngjarjes, duke mos dënuar personat kryesorë shkaktarë për vrasjen e djalit të tij, të ndjerin Xh. P.

86.1. Në lidhje me këtë çështje, trupi gjykues në vijim kreu disa verifikime¹²² në lidhje me statusin e kësaj çështje. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë njofton se pranë kësaj gjykate ka ardhur për shqyrtim kërkesa për gjykim e datës 23.12.2021, në lidhje me procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasve R. H.dhe N. Sh., si dhe kërkesa për pushim të hetimeve e datës 21.12.2021, në ngarkim të shtetasve S.H.dhe B. M. Nga verifikimet e kryera në sistemin *ICMIS* rezulton se në lidhje me këtë çështje është regjistruar kërkesa penale me nr. ***, akti dhe numër elektronik *** dhe se kjo çështje është aktualisht në shqyrtim pranë kësaj gjykate në fazën e seancës paraprake.

86.2. Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, kreu verifikimet në lidhje me statusin e kësaj çështje, si dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në orientimet e dhëna nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit¹²³ në lidhje me çështjen në shqyrtim, çmon se kontrolli i aftësisë profesionale nuk mund të kryhet për këtë çështje, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, pasi për rrjedhojë do të paragjykohej zgjidhja e një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit. Ndërsa në lidhje me njoftimin e babait të viktimës, subjekti shpjegoi dhe provoi se kishte kryer njoftimin ndaj tij, duke paraqitur në cilësinë e provës kopje të njësuar të fletës së *“librit të korrespondencës me postën sekrete”*.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

87. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, si dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Shehaj:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, germa “c” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

87.1. Trupi gjykues, lidhur me konkluzionin sipas pikës c, është bazuar në dispozitat ligjore: i) nenin E, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: *“Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”*; ii) nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *“Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”*; iii) vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: *“...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale* (shih edhe opinionin CDL -AD (2016) 036, të Komisionit të

¹²² Korrespondencë elektronike e mbajtur me kancelaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, datë 30.3.2022 dhe kthim përgjigjeje datë 31.3.2022.

¹²³ Vendim (JR) nr. 33, datë 3.11.2021.

Venecias); iv) nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë...”.

87.2. Në analizë të këtyre dispozitave ligjore, trupi gjykues ka konstatuar se mangësitë e konstatuara në 2 çështjet penale të referuara sa më sipër, nuk janë të mjaftueshme:

- i. për t'i çmuar ato si sjellje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e këtij prokurori (duke marrë në konsideratë trajtimin që ai ka bërë në dosjet e tjera);
- ii. për ta vlerësuar atë me mangësi profesionale; si dhe
- iii. nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë//praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij.

87.3. Në rrethanat konstatuese, jo vetëm të evidentimit të mangësive për dy çështjet penale, por edhe të rrethanave specifike në vetvete që ato paraqesin, trupi gjykues vlerëson se në zbatim të nenit 59, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, çështjet e mëposhtme duhet të transferohen pranë organit kompetent për inspektim, nëse verifikohen shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore: a) lidhur me procedimin penal nr. ***, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal ndaj të pandehurit shtetasit N.LL., për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”; b) lidhur me procedimin penal nr. ***, me të pandehur shtetasin D.G., për veprën penale “Kanosje e gjyqtarit”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe 59, pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Erjon Shehaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

2. Bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, transferimin pranë organit kompetent, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, të dy dosjeve hetimore si më poshtë:

a) lidhur me procedimin penal nr. ***, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal ndaj të pandehurit shtetasit N.LL., për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”.

b) lidhur me procedimin penal nr. ***, me të pandehur shtetasin D.G., për veprën penale “Kanosje e gjyqtarit”.

3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij, me përjashtim të pikës 2 të tij. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 1.4.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma Faskaj (Vokopola)
Kryesuese

Brunilda Bekteshi
Anëtare

Pamela Qirko
Relatore

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS 1 - ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE 2008-2016

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	8,623	7,194,450	-444,498	105,811	240,087	-44,751	2,097,107	-327,673	343,502
Apartament me sipërfaqe 84m2 +10m2 sipërfaqe e përbashkët në Rrugën "****", Tiranë. pall.		6,584,160					1,961,540		
Automjet tip *** me targa AA***OU, ngjyrë jeshile, prodhim i vitit 2005. Vlera 300.000 lekë, datë 15.11.2016.									300,000
Ndryshim likuiditeti	8,623	610,290	-444,498	105,811	240,087	-44,751	135,567	-327,673	43,502
B) DETYRIME	0	6,829,208	0	0	0	0	2,031,595	0	0
Detyrim I mbetur ndaj shoqërisë "****" Shpk		329,208					70,055		
Kredi bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale 4.000.000 lekë datë 2.10.2009 OTP BANK		4,000,000							
Hua e marrë në vlerën 2.500.000 lekë sipas deklaratës noteriale nr.***rep/kol datë 16.9.2009 nga shtetasi N. Sh.		2,500,000							
Hua e marrë në vlerën 14.000 euro sipas deklaratës noteriale nr.***/rep/kol datë 15.11.2013 nga shtetasi N.Sh.							1,961,540		
C) PASURI NETO (A-B)	8,623	365,242	-444,498	105,811	240,087	-44,751	65,512	-327,673	343,502
D) TË ARDHURA	1,622,337	1,655,791	1,354,129	1,726,232	1,686,726	1,700,233	2,072,017	2,071,127	1,836,907
Të ardhura nga paga SR	768,830	791,443	794,720	832,024	867,367	946,274	1,097,414	1,074,377	1,089,467
Të ardhura nga paga BSH	853,507	864,348	559,409	894,208	819,359	753,959	974,603	996,750	747,440
Të ardhura nga ekspertiza me OSCE E.Sh BSH									
Të ardhura nga ekspertiza me Regional School Public Admin BSH									
E) SHPENZIME	273,240	386,840	891,298	1,311,180	1,181,758	995,283	1,526,311	1,748,613	1,889,883
Shpenzime minimale jetike	273,240	273,240	396,198	409,860	423,072	423,072	659,994	672,828	846,331
Shpenzime të tjera (apartamenti nr1)									
Shpenzime për shlyerje kredie pranë OTP BANK		74,000	442,300	448,520	472,500	468,400	392,500	511,878	432,000
Shpenzime për shlyerje kredie pranë ALPHA BANK									
Shpenzime për shlyerje huaje ndaj babait N.SH				400,000	200,000		400,000	200,000	200,000
Shpenzime arsimit për fëmijët								50,000	120,000
Shpenzime për udhëtimet jashtë vendit					6,986	7,011	21,017	261,107	103,482
Shpenzime për udhëtimin në vendin e punës në Kavajë BSH		39,600	52,800	52,800	52,800	44,000			
Shpenzime për udhëtimin në vendin e punës në Lezhë SR					26,400	52,800	52,800	52,800	52,800
Shpenzime shëndetsore									135,270
Balanca e fondeve (D-C-E)	1,340,474	903,709	907,329	309,241	264,881	749,702	480,195	650,187	-396,478